

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësajellës Kanalizime

2014



Publikuar nga
Enti Rregullator i Ujit i Shqiperise (ERRU)
Blv. Gjergj Fishta, Nr.10
Tirane, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel.: 00355 4 2258046
Faqja e internetit: www.erru.al

©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Nentor 2015

ISSN: 2305-3445



Implemented by



Printimi i këtij publikimi u mbështet nga

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programi për Reformën e Ujit, Shqipëri

Vizioni

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme për të gjithë konsumatorët në Shqipëri

Misioni

Të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht

Përmbajtja

Shkurtime	4
Fjala Përshëndetëse	5
Hyrje	7
1. ERRU dhe Veprimtaria gjatë Vitit 2014	9
1.1. Përshkrimi i Rolit dhe Mandatit të ERRU-së	9
1.2. Rëndësia e Rregullatorit për Zhvillimin e Sektorit	9
1.3. Licencimi	10
1.4. Rregullimi i Tarifave	11
1.5. Mbrojtja e Klientit dhe Rritja e Transparencës.....	12
2. Ecuria në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime gjatë vitit 2014	14
2.1. Zhvillimet kryesore	14
2.2. Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendencat.....	17
3. Analiza e performancës për shoqëritë ujësjetës kanalizime	21
3.1. Metodologjia e analizës së performancës.....	21
Treguesit kryesorë të performancës.....	21
Grupet e shoqërive	23
Analiza e performancës në lidhje me objektivat e vendosur nga ERRU	25
Renditja e Shoqërive Ujësjetës Kanalizime.....	26
Saktësia dhe Besueshmëria e të dhënave	27
3.1.1. Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes	27
3.1.2. Mbulimi i kostove totale	33
3.1.3. Norma e Arkëtimit	38
3.1.4. Efienca e Stafit	43
3.1.5. Uji pa të ardhura	49
3.1.6. Niveli i matjes	55
3.1.7. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë	60
3.1.8. Mbulimi me kanalizime	65
3.1.9. Perceptimi Rregullator	70
3.2. Renditja e Shoqërive Ujësjetës Kanalizime	75
4. Temë e Veçantë për vitin 2014: Mbrojtja e Konsumatorit	80
5. Konkluzione dhe Perspektiva për të Ardhmen	83
6. Aneke	86

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
SHA	Shoqëri Aksionere
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizime
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ISHP	Instituti Shëndetit Publik
DRSH	Drejtoria Rajonale Shëndetësore
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit / Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar
IWA	International Water Association / Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimin të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto operative dhe mirëmbajtje

Fjala përshëndetëse

Raportimi i Performancës së shoqërive UK, prezantuar nga ERRU që nga viti 2011, është tashme prej katër vitesh pjesë e sistemit raportues rregullator.

Si një nga instrumentet kryesor të transparencës, raporti synon të mundësojë të gjithë aktorëve dhe publikut të gjerë, të kuptojnë dhe të krahasojnë performancën e ofruesve të shërbimeve të licencuar. Për më tepër çdo operator mund të shohë ecurinë e performancës së shërbimeve në kohë dhe krahasimisht me operatorët e të njëjtit grupim.

Po kështu, kjo analize ndihmon në realizimin e misionit të Entit Rregullator si dhe në përmirësimin e standardeve, metodologjive apo praktikave që ai përdor për të bërë të mundur këtë krahasim performance.

Arritja e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit UK mbetet një nga sfidat kryesore për sektorin. Ndërsa në qendër të vëmendjes së ERRU është ofrimi i shërbimeve me cilësinë më të mirë të mundshme dhe me një çmim të arsyeshëm.

Për vitin 2014, analiza e treguesve të performancës konfirmoi se përgjithësisht sektori ka pasur një tendence pozitive. Arkëtimi i të ardhurave ka pësuar rritje, tregues ky i lidhur drejtpërdrejt me menaxhim më të mirë nga shoqëritë, por këtij menaxhimi i ka ardhur në ndihmë dhe fryma e ndjekur nga qeverisja qendrore.

Si rrjedhim i rritjes së arkëtimeve dhe politikës tarifore të ndjekur nga ERRU, trend pozitiv vazhdon të ketë dhe niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së asaj totale. Po kështu dhe niveli i matjes apo kohëzgjatja e furnizimit me ujë kanë pësuar rritje krahasuar me një vit më parë, megjithëse akoma larg objektivave strategjike të vendosura në sektor.

Shqetësim kryesor vazhdon të mbetet niveli i papranueshëm i ujit pa të ardhura, pavarësisht progresit të dukshëm në rritjen e përqindjes së shërbimeve të matura dhe në rritjen e kapacitetit menaxherial. Mbajtja në nivel pothuajse konstant i humbjeve, ka impakt negativ në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK dhe ndikon drejtpërdrejt në performancën e shërbimeve.

ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë tregues të rëndësishëm në përmbushjen e mandatit të tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit. Shoqëritë, megjithë masat e marra për përmirësimin e cilësisë së ujit në pikën e furnizimit, për shumë arsye të tjera (furnizimi i ujit me ndërprerje, ndryshimet në presion, lidhjet e paligjshme, depozitat dhe pompat thithëse të instaluar dhe funksionimi i tyre jashtë standarteve) nuk garantojnë cilësinë e ujit tek konsumatorët. Kjo thekson ndërvarësinë e fushave të ndryshme të performancës së shoqërive për të siguruar ujë cilësisht të pastër, por gjithashtu kërkon dhe një ndërveprim dhe bashkërendim të strukturave përkatëse indirekt monitoruese të cilësisë së ujit.



Në opinionin tonë, ky bashkërendim do të unifikonte jo vetëm standardin e raportimit dhe llojet e nevojshme të analizave, por do të përmirësonte dhe saktësinë e këtij informacioni. Me keqardhje them që dhe për këtë vit ky bashkërendim në monitorimin dhe raportimin mbi cilësinë e ujit të pijshëm nuk është arritur.

Pavarësisht problemeve në sektor dhe problematikave të shfaqura në shumë shoqëri UK, kam kënaqësinë të shpreh se analiza e vitit 2014, përveç se shënoi një përmirësim të të gjithë tregueseve në sektor, tregoi dhe një tendence pozitiv për shumë më tepër shoqëri UK që tashmë renditen në grupin e performuesve të mirë. Jam i bindur që secila shoqëri që e ka kaluar këtë prag, ndjehet sot krenare që renditet ndër më të mirët dhe uroj që këtë ritëm pozitiv ta ruajnë dhe në vitet në vazhdim. ERRU do të jetë gjithmonë e gatshme ti mbështesë në punën e tyre në zhvillimin e sektorit, pavarësisht sfidave të shumta dhe problemeve.

Në përfundim do të doja të falenderoja të gjithë punonjësit e ERRU-së për punën dhe dedikimin që kanë treguar në përgatitjen e këtij raporti, si dhe partneret tanë të GLZ, si bashkëpunëtorë kryesorë, tashme prej vitesh, në rritjen e kapaciteteve institucionale të ERRU-së.

Avni **DERVISHI**



KRYETAR
Enti Rregullator i Ujit



Hyrje

Vlerësimi i performancës së sektorit UK dhe shoqërive të licencuara që operojnë në të, i cili ka filluar që nga viti 2011, tashmë është një nga raportimet e vazhdueshme periodike që ERRU përgatit në vijim të Raportit Vjetor i cili publikohet në fund të muajit Janar.

Ky Raport ka si synim të ofrojë një tablo të pavarur dhe objektive të gjendjes në sektor, si dhe ti mundësojë të gjithë aktorëve dhe publikut të gjerë të informohet dhe të krahasojë performancën e çdo ofruesi të këtij shërbimi.

Si një nga instrumentet që ndihmon në rritjen e transparencës, qëllimi kryesor i këtij Raporti është të nxisë konkurrencën mes operatorëve të shërbimeve ujësjellës kanalizime, të cilat aktualisht veprojnë në kushtet e një monopoli. Përmes analizimit të performancës së operatorëve individualisht dhe duke i krahasuar ato me operatorët e tjerë, mbi bazën e një sërë treguesish performance të përzgjedhur nga ERRU, shoqëritë mund të identifikojnë mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

Dhënia e mundësisë gjithë aktorëve të interesuar, duke përfshirë edhe konsumatorët, që të shohin progresin e arritur në sektorin e ujësjellës kanalizime dhe të vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal përbën edhe një stimul të fuqishëm për përpjekjet e operatorëve për përsosmëri në ofrimin e shërbimit. Ne besojmë se drejtuesit e ndërmarrjeve do të preferonin t'i shihnin shoqëritë e tyre mes më të mirave dhe sigurisht jo midis më të dobëtave, në çdo raport pasardhës.

Raporti është i strukturuar në gjashtë pjesë ku:

- Në pjesën e parë paraqiten shkurtimisht veprimtaritë dhe arritjet kryesore të ERRU gjatë vitit 2014.
- Në pjesën e dytë paraqitet performanca e përgjithshme e sektorit ujësjellës kanalizime gjatë vitit 2014.
- Në pjesën e tretë, e cila është edhe pjesa më e rëndësishme e këtij raporti, paraqitet analiza e performancës së shoqërive, për secilin nga TKP e marra në shqyrtim. Kjo pjesë përmbyllet me pjesën e katërt të raportit ku jepet renditja e shoqërive në bazë të rezultateve të arritura.

- Në pjesën e pestë të raportit për këtë vit si temë e veçantë është trajtuar një nga funksionet më të rëndësishme të Rregullatorit, Mbrojtja e Konsumatorit, e fokusuar në instrumentet që ERRU ka përmirësuar gjatë vitit në raportim.
- Raporti mbyllet me pjesën e gjashtë ku paraqitet një përmbledhje e konkluzioneve kryesore.
- Në përfundim është një përmbledhje aneksesh me të dhëna të detajuara për shoqëritë UK dhe tarifat që ato zbatojnë.

Erru dhe veprimtaria Gjatë vitit 2014



Përshkrimi i Rolit dhe Mandatit të ERRU-së

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) është një institucion i pavarur publik që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

ERRU ushtron funksione rregullatore në sektorin ujësjellës-kanalizime. Këto funksione përfshijnë licencimin e operatorëve të shërbimeve, miratimin e tarifave të shërbimit, vendosjen e standarteve e rregullave uniforme në sektor, monitorimin e punës së operatorëve, raportimin mbi gjendjen e sektorit, etj.

Rëndësia e Rregullatorit për Zhvillimin e Sektorit

Ekzistenca e një institucioni rregullator në sektor, është e domosdoshme me qëllim orientimin e këtyre shërbimeve drejt ekonomisë së shkallës, si edhe në përcaktimin e politikave tarifore të drejta, të pavarura dhe të paanshme. Gjithashtu një rregullator i pavarur shërben për rritjen e transparencës dhe shkallës së informimit të publikut dhe qeverisjes rreth zhvillimeve të sektorit UK, duke shërbyer kështu si një burim alternativ i informacionit, i benchmarking dhe i shqyrtimit e vlerësimit të shërbimeve UK.

ERRU gjatë përmbushjes së detyrave që i përcakton ligji, udhëhiqet nga parimi i paanshmërisë dhe gjetjes së ekuilibrit mes interesave të gjithë palëve në sektorin UK, konsumatorëve, operatorëve të shërbimeve, qeverisjes qendrore, qeverisjes vendore dhe investitorëve.

Aktualisht ligji i funksionimit të ERRU është në proces ndryshimi. Qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve është kalimi nën kompetencën e ERRU-së dhe të miratimit të tarifave të depozitimit të mbetjeve jo të rrezikshme në landfille dhe në impiantet e incenerimit. Ky propozim mbështetet me argumentin se deri më sot, depozitimi i këtyre mbetjeve nuk është i rregulluar ligjërisht përsa i përket anës ekonomike të përcaktimit të tarifave të depozitimit të tyre në landfille.

Përveç këtij aspekti, në draftin e ligjit janë bërë edhe disa shtesa dhe ndryshime që kanë si qëllim përcaktimin e një pavarësie të qartë institucionale të ERRU dhe forcimin e rolit të saj nëpërmjet:

- miratimit të anëtarëve të komisionit drejtues nga Kuvendi,
- rritjes së pavarësisë financiare;
- rritjes së rolit të Entit në mbrojtjen e konsumatorëve;
- si edhe rritjes së masave të sanksioneve ndaj operatorëve që shkelin detyrimet ligjore.

Licencimi

Gjatë vitit 2014 një aspekt i rëndësishëm i punës së ERRU-së ka qenë edhe monitorimi i situatës së licencimit në sektor dhe përpjekja për të sjellë në vëmendjen e shoqërive respektimin e kushteve të licencimit.

Pranë Entit Rregullator të Ujit për vitin 2014 kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence 22 shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të kërkuar, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar 13 (trembëdhjetë) operatorë, ndërsa 9 (nëntë) aplikime të tjera kanë mbetur ende në proces. Po gjatë këtij viti, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar dhe 2 (dy) shoqëri të tjera, aplikimet e të cilave vinin nga viti paraardhës, por që dokumentacioni u plotësua nga shoqëritë në vitin 2014.

Gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë apo rinovim licence gjatë vitit 2014, nga ana e shoqërive që operojnë në sektorin UK, u hasën përsëri problematika që janë të njohura për ERRU-në. Ndër to, si më kritike, mund të përmendim ndryshimi i drejtuesit ligjor/teknik brenda një periudhe shumë të shkurtër (dhe disa herë brenda një viti), vështirësi në gjetjen e një drejtuesi të kualifikuar teknik ose një drejtuesi të dytë për shoqëritë që kanë në funksionim impiante, vështirësi në regjistrim dhe reflektimin e ndryshimeve në QKR, vonesa në dorëzimin e dokumenteve të nevojshme nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së licencimit.

Për shkak të problematikave të paraqitura më sipër, situata e licencimit deri në fund të vitit 2014, për 57 shoqëritë UK që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime është:

- 40 (dyzet) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- 9 (nëntë) operatorë janë në proces për rinovimin e licencës;
- 5 (pesë) operatorëve u ka përfunduar afati por nuk kanë aplikuar akoma për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim;
- 3 (tre) operatorë janë pa licencë.

ERRU si institucion ka qenë gjithmonë bashkëpunues dhe i gatshëm për të ndihmuar dhe mbështetur shoqëritë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Rregullimi i Tarifave

ERRU është autoriteti që miraton tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për grumbullimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin e tyre, për të gjithë të licencuarit në sektorin ujësjellës-kanalizime.

Bazuar në kompetencat që i jep ligji, ERRU ka përcaktuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura në Metodologjinë "Për miratimin e tarifave", të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë subjektet e licencuar.

ERRU duhet ti sigurojë konsumatorët se tarifat që ata paguajnë bazohen në kostot e domosdoshme dhe të arsyeshme për shërbimet e ofruara. Synimi i ERRU-së është mbulimi i menjëhershëm i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, ndërsa mbulimi i kostove totale është objektiv më i largët. Politika tarifore e ndjekur nga ERRU përfshin një rritje graduale të tarifave në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet me përmirësime të performancës së shërbimeve.

Në vitin 2014, pranë ERRU paraqitën kërkesën për ndryshimin e tarifave 13 shoqëri, prej të cilave:

- Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Gjirokastrë, Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. UK Lushnjë, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Ersekë dhe Sh.a. UK Korçë janë shoqëri të cilat kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave edhe në vitin paraardhës. Për këto shoqëri aplikimi i përvitshëm për ndryshimin e tarifave bazohet në planet e tyre të biznesit.
- Sh.a. UK Himarë dhe Sh.a. U Korçë Fshat aplikojnë për herë të parë për miratimin e tarifave pranë ERRU-së.
- Shoqëritë Sh.a. UK Krujë, Sh.a. U Elbasan Fshat, Sh.a. U Poliçan dhe Sh.a. UK Kukës aplikojnë tarifa të miratuara nga ERRU përkatësisht në vitin 2007, 2010 dhe 2011.

Procesi i miratimit të tarifave (i cili kalon në disa hapa), fillon me paraqitjen e aplikimit për ndryshimin e tarifave, i cili duhet të plotësohet nga shoqëritë UK në përputhje me kërkesat e Metodologjinë "Për miratimin e tarifave". Nëse dokumentacioni i aplikimit nuk është i plotë, procedura e miratimit të tarifave, fillon pas plotësimit të këtij dokumentacioni. Paraqitja e aplikimeve nga operatorët bëhet brenda datës 30 qershor të çdo viti. Afati i fundit për miratimin e tarifave nga Komisioni Kombëtar Rregullator është 30 marsi i vitit pasardhës.

Në muajin Mars të vitit 2014, KKRR, në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore të përcaktuara në Metodologji, miratoi tarifat për Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Lushnjë Qytet dhe Sh.a. UK Berat-Kuçovë, për të cilat procesi i miratimit të tarifave kishte filluar sipas aplikimeve të paraqitura për ndryshimin e tarifave në vitin 2013.

Në lidhje me aplikimet e paraqitura për ndryshimin e tarifave në vitin 2014, ERRU shqyrtoi kërkesat e paraqitura për ndryshimin e tarifave, rast pas rasti, në varësi të plotësimit të dokumentacionit të aplikimeve për ndryshimin e tarifave.

Për shoqëritë Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Kukës, Sh.a. UK Gjirokastër, Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Lushnjë dhe Sh.a. UK Himarë, Komisioni vendosi të mos marrë në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e tarifave, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të aplikimit në përputhje me kërkesat e Metodologjisë. Procedura për miratimin e tarifave për këto shoqëri do të vazhdojë në vitin pasues, pasi ato të kenë plotësuar aplikimin me dokumentacionin e munguar dhe të kenë përditësuar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar. Ndërsa bazuar në analizën e kryer, Komisioni Kombëtar Rregullator, miratoi tarifat për Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Ersekë, Sh.a. U Poliçan, Sh.a. U Elbasan Fshat dhe Sh.a. U Korçë Fshat.

Objekтиви kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Në funksion të këtij objekтиви ERRU nëpërmjet instrumenteve rregullatore, si struktura tarifo-re, subvencioni i kryqëzuar, organizimi i seancës dëgjimore, monitorimi i efikasitetit dhe efektivitetit të ofruesve të shërbimit është përpjekur që tarifat e miratuara të jenë të përballueshme për konsumatorë, por edhe t'i sigurojnë operatorëve mjetet financiare të nevojshme për mbulimin e kostove. Për shumë operatorë pagesa e kostove të kredive si dhe mirëmbajtja e investimeve kanë rritur ndjeshëm kostot e shërbimeve që ato kryejnë. Një pjesë e këtyre kostove mund të mbulohen përmes tarifave, por mbulimi total i tyre mund të mos jetë i përballueshëm nga klientët dhe rritja e mëtejshme e tarifave mund të sjellë efekte negative sociale. Në vitin 2014, në kuadër të Programit “Mbështetje për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime në Shqipëri”, “Përballueshmëria e Tarifave për Shërbimet Ujësjellës-Kanalizime për Konsumatorët Familjarë me të Ardhura nën Nivelin e Varfërisë” është trajtuar si një çështje më vete. ERRU ka mbështetur studimin e kryer në këtë drejtim.

Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të përgatitur nga ekspertët për këtë çështje janë mbajtur parasysh gjatë vlerësimit të ndryshimit të tarifave dhe do të ndihmojnë gjithashtu në zgjidhjen e problemeve që lidhen me përballueshmërinë. Gjetja e mekanizmave të përshtatshëm për subvencionimin e shtresave në nevojë kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve që përfshihen në këtë çështje.

Mbrojtja e Klientit dhe Rritja e Transparencës

Në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, ndryshimet e propozuara në ligj pritet të rregullojnë një aspekt tepër të rëndësishëm të të drejtave të konsumatorëve, siç është e drejta për t'u ankuar.

Ky proces mbetet një nga problemet më të ndjeshme në marrëdhënien mes ERRU-së dhe konsumatorëve, i cili ka jo pak vështirësi në trajtim. Çështja e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave mbetet një çështje e pa adresuar si duhet. Parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, disa prej të cilave janë të vjetra në kohë, nuk i përgjigjen zhvillimeve aktuale dhe nuk rregullojnë plotësisht të drejtat e detyrimet e palëve.

Në këtë situatë pjesë e zgjidhjes së këtij problemi, janë ndryshimet që priten t'i bëhen ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ku pjesë e të cilave është dhe shtimi i kompetencës së KKRR për marrjen e vendimit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Misioni i ERRU është të sigurojë për të gjithë klientët e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri shërbim me cilësinë më të mirë të mundshme dhe me një çmim të arsyeshëm. Duke patur parasysh të drejtën e konsumatorëve për të patur një shërbim cilësor si dhe nevojën për të drejta dhe detyrime të qarta, ERRU vendosi që prej muajit Shtator 2014, që kontrata model të jetë një kontratë tip, e cila rregullon detyrimisht të gjitha marrëdhëniet mes konsumatorëve dhe operatorëve të shoqërive UK në Shqipëri, pavarësisht nënshkrimit të saj ose jo nga palët.

Kjo kontratë jo vetëm përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve, por shërben edhe si një instrument që sanksionon procedurat që duhet të ndiqen për të siguruar një marrëdhënie të drejtë dhe transparente mes konsumatorëve dhe operatorëve.

Ecuria në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve 2014



Në këtë pjesë të raportit jepet një pamje e përgjithshme e nivelit të performancës dhe zhvillimeve kryesore në sektorin UK përgjatë vitit 2014. Vlerësimi i performancës së sektorit tregon arritjet e përbashkëta të 57 shoqërive krahasuar me objektivat strategjike të zhvillimit të sektorit 2011-2017 si dhe ato të vendosur nga Enti Rregullator i Ujit.

Zhvillimet kryesore

Në objektivat kryesore të ERRU-se bëjnë pjesë, veç të tjerave dhe pajisja me licencë e aplikimi i tarifave të miratuara prej tij, për të gjithë operatorët në sektorin UK, duke krijuar një mjedis rregullator të qëndrueshëm dhe transparent në sektor. Aktualisht, nga 57 operatorë, 49 prej tyre janë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit dhe 48 operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU. Kjo situatë është rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm të ERRU me operatorët për rregullimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura brenda kuadrit ligjor.

Sektori i shërbimeve UK funksionon kryesisht nëpërmjet operatorëve të organizuar si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor, në zonën administrative të të cilit operatori ofron shërbimin. Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë nga këto shoqëri kryhet për 80.8% të popullsisë që jeton në zonën e tyre të juridiksionit, ndërsa shërbimi me kanalizime i ofrohet 51% të kësaj popullsie. Vetëm rreth 10% e popullsisë në zonën e juridiksionit përfiton edhe trajtimin e ujërave të ndotura mbulon.

Shërbimi me kanalizime vazhdon të mbetet prapa atij të furnizimit me ujë. Përmirësimi i këtij shërbimi kërkon akoma më shumë përpjekje për të rritur shkallën e mbulimit me këtë shërbim si dhe nivelin e tij për të mundësuar mbrojtjen e ujërave dhe të mjedisit. Ky shërbim në sektor është ofruar nga 32 operatorë, 5 prej të cilëve kryejnë edhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Për pjesën tjetër të popullsisë, ai kryesisht kryhet nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat nuk e kanë transferuar atë pranë shoqërive të ujësjellësit në varësi të njësisë përkatëse. Për popullsinë jashtë zonave të juridiksionit të operatorëve, shërbimi ofrohet nga sektorë që veprojnë brenda njësive të qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive që nuk janë të

licencuar nga ERRU. Rezultatet e studimit që Enti Rregullator i Ujit përfundoi mbi të gjitha zonat e pambuluara me shërbim ujësjellës kanalizimesh të licencuar do të shërbejnë për të arritur në rekomandime konkrete për rregullimin e shërbimit ujësjellës kanalizime të ofruar në këto zona.

Asetet e shoqërive UK në zbatim të reformave të decentralizimit dhe të funksioneve të NJQV, sipas ligjit për qeverisjen vendore, janë transferuar në mënyrë graduale me vendime të ndryshme të Këshillit të Ministrave pranë njësive vendore. Në rastet kur shoqëria UK mbulon më shumë se një njësi të qeverisjes vendore, aksionet e saj janë ndarë në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë të secilës njësi. Megjithatë, njësitë vendore, shpesh, nuk i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në raport me këtë shërbim, për rrjedhojë edhe kërkesa e llogarisë për shoqëritë UK mbi gjendjen e shërbimit dhe punën e kryer pothuajse nuk funksion.

Reforma administrative e miratuar së fundmi është një hap tepër i rëndësishëm për sektorin UK. Kjo reformë do të sjellë riorganizimin e shoqërive sipas hartës së re të organizimit të territorit, duke krijuar të gjitha kushtet për një menaxhim më të mirë, sipas parimeve të rajonalizimit dhe ekonomisë së shkallës. Gjithashtu kjo reformë eliminon disa fenomene negative që ndikojnë në sektor.

Reforma do të lehtësojë mjaft çështjen e rregullimit ligjor të zonave të pambuluara, pasi mjaft njësi do të bëhen pjesë e bashkive/komunave më të mëdha. Në të ardhmen, shërbimet UK do të ofrohen nga operatorë të licencuar në të gjithë territorin e vendit.

Evidentimi dhe regjistrimi i aseteve të sistemeve të ujësjellës kanalizimeve për shoqëritë e reja, si dhe çertifikimi i tyre në Zyrën së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, do të eliminojë parregullsitë e konstatuara në këtë drejtim. Inventari i aseteve do të përfshijë jo vetëm asetet ekzistuese të shoqërive UK por edhe ato asete të përfituara nga investimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore, aksionare të shoqërive UK, që aktualisht nuk janë pjesë e inventarit të këtyre shoqërive si dhe asetet e pushteteve vendore, kryesisht komuna, të cilat deri më tani janë administruar nga sektorë brenda këtyre komunave dhe nuk kane qenë pjesë e juridiksionit të shoqërive UK.

Gjithashtu, riorganizimi i shërbimeve UK si funksion i njësive të reja vendore, besohet se do të zgjidhë problemin e llogaridhënies së drejtuesit të shoqërisë kundrejt pronarit.

Në vitin 2014 sektori është duke u zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme. Pjesa më e madhe e treguesve kanë shënuar progres krahasuar me një vit më parë. Edhe këtë vit të ardhurat e shoqërive UK mbulojnë mesatarisht mbi 100% të kostos operative dhe të mirëmbajtjes për sektorin. Të ardhurat në sektor janë rritur rreth 3% krahasuar me vitin 2013, ndërsa kostot janë ulur me rreth 3%, gjë e cila ka sjellë edhe rritjen e shkallës së mbulimit të kostove me të ardhura.

Gjithashtu për vitin 2014 aftësia paguese e shoqërive është përmirësuar, pasi niveli i arkëtimit është rritur me rreth 11% krahasuar me një vit më parë. Shkak i reflektimeve pozitive në rritjen e likuiditetit të shoqërive është edhe vendosmëria e shprehur hapur nga qeveria lidhur me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në të gjitha shërbimet si nga ana

e subjekteve ekonomike ashtu edhe nga konsumatorët. Nën këtë frymë shoqëritë kanë përmirësuar treguesit ekonomike, dhe kanë ulur detyrimet e pashlyera ndaj të tretëve. Megjithëse mesatarja e rezultateve financiare është premtuese, fakti që humbjet e ujit mbeten në nivel të lartë, përbën një nga shqetësimet kryesore në sektor. ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve, edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve kërkon kohë dhe investime. Analiza e humbjeve bazuar në “Bilancin e ujit” jep të dhëna të detajuara në lidhje me sasinë e ujit të prodhuar, atij të faturuar, nivelin e humbjeve dhe shkaqet e tyre. Analiza e këtyre të dhënave i shërben si rregullatorit ashtu edhe shoqërive për vlerësimin e situatës dhe programimin e masave që duhet të merren për përmirësimin e saj. Investimet kapitale luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës në sektor. Burimi kryesor i investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit si dhe kreditë dhe grantet nga donatorët e huaj. Këto investime janë fokusuar në rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Një vend të rëndësishëm zënë investimet për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e këtyre investimeve si dhe pagesat për koston e kredive për shumë operatorë zënë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos, prandaj edhe sigurimi i mjeteve financiare për mbulimin e tyre merr një rëndësi të veçantë. Edhe gjatë vitit 2014 qeveria ka akorduar subvencione, por burimi kryesor i të ardhurave për operatorët janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët.

Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendencat

Në tabelën e mëposhtme paraqitet performanca e përgjithshme e sektorit për vitin 2014 si dhe ecuria e tij për tre vite 2012-2014. Tabela bën të mundur bërjen e një krahasimi të shpejtë të performancës aktuale të vitit 2014 kundrejt objektivave të vitit 2014 të paraqitura në strategjinë aktuale të sektorit, si dhe kundrejt niveleve sfiduese të objektivave për performancë të mirë të vendosura nga ERRU.

Treguesit e Performancës	2012	2013	2014	Tendencat e Performancës	Performancë e Mire (ERRU)	Objektivat e Strategjisë së Sektorit (2014)
Mbulimi i Furnizimit me Ujë	80.8%	80.8%	80.8%	=	n/a	93%
Mbulimi me Kanalizime	51%	51%	51%	=	75%	85%
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	10.8	11.5	12.1	↗	18	15
Mbulimi i Kostos Totale	82.7%	84.6%	87%	↗	80%	74%
Mbulimi i Kostove O&M	106.3%	113.8%	122%	↗	100%	100%
Norma e Arkëtimit	90.9%	82%	91%	↗	82%	92%
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje)	9.3	9.5	8.9	↗	4/6/10	n/a
Uji pa të Ardhura	67.1%	67.4%	67.2%	≈	30%	54%
Niveli i Matjes	55.1%	59%	61.2%	↗	85%	65%

Tabela 1. Përmbledhje e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizime për vitin 2014, Burimi informacionit: ERRU

Në vitin 2014, pjesa më e madhe e treguesve kanë bërë progres, por vetëm treguesit e mbulimit të kostos kanë arritur objektivat e strategjisë për sektorin dhe objektivin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU.

Mbulimi me shërbime ujësjellës-kanalizime përfaqëson numrin total të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit të shoqërive UK dhe i përfiton këto shërbime nga shoqëria. Niveli i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime nga shoqëritë UK nuk ka ndryshuar as këtë vit. Popullsia që jeton në zonat urbane ka më shumë akses në shërbimin e furnizimit me ujë dhe grumbullimin e largimin e ujërave të ndotura të ofruar nga shoqëritë UK, 76% e mbulueshmërisë në furnizimin me ujë dhe 98% në shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura i përket zonës urbane. Popullsia në zonat rurale ka akses kryesisht vetëm në furnizimin me ujë, 24% e kësaj popullsie përfiton shërbimin e furnizimit me ujë dhe vetëm 2% e kësaj popullsie mbulohet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura. Në zonat rurale nivelet e arritura tregojnë se mbulimi me shërbimet UK është larg objektivave të zhvillimit të sektorit.

Në vitin 2014, rezultatet tregojnë për një ecuri të mirë të sektorit në drejtim të mbulimit të kostove. Mbulimit i kostove O&M me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor është 122% dhe numri i shoqërive që mbulojnë mbi 100% koston e operimit dhe mirëmbajtjes ka shkuar në njëzet e një. ERRU e konsideron mbulimin e kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen.

Mesatarja e mbulimit të kostos totale për sektorin është 87%. Shtatë operatorë kanë arritur të mbulojnë me të ardhurat e tyre të gjitha shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara. Kryesisht janë shoqëritë e mëdha ato që kanë arritur këtë rezultat. Gjithsesi, rezultati përmbledhës fsheh performancën e dobët të disa shoqërive, kryesisht operatorë të vegjël, që nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë me të ardhurat e tyre. Gjatë tre viteve të fundit niveli i mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti ka shënuar progres, si rezultat i rritjes së të ardhurave, dhe mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve. Analiza e strukturës së kostos bën të mundur të përcaktohet për çfarë është shpenzuar më shumë, cilat janë arsyet, si dhe ku duhet të përqendrohen përpjekjet për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.

Përqindjen më të madhe në totalin e kostove e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit, prandaj edhe përpjekjet e shoqërive duhet të përqendrohen për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve. Një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi efektiv është përmirësimi i efikasitetit operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit.




Figura 1. Struktura e kostos së shërbimeve UK për vitin 2014.

Përgjithësisht operatorët UK kanë numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Për vitin 2014, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 8.9 punonjës/1000 lidhje. Për një numër të vogël operatorësh, niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është më shumë se 4-5 punonjës/1000 lidhje. Por për disa të tjerë numri i

punonjësve për 1000 lidhje është sa dyfishi i nivelit mesatar të sektorit, gjë e cila bën që kostot e personelit të zënë më shumë së gjysmën e shpenzimeve vjetore të shoqërisë. Pas kostove të personelit, kostot e energjisë elektrike janë ato që zënë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. Për operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, efënca e energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë zë të shpenzimeve.

Ulja e kostos së energjisë elektrike për shërbimin e furnizimit me ujë është e lidhur edhe me përmirësimin e disa treguesve të tjerë si reduktimi i humbjeve, vendosja e matësve, por edhe me një menaxhim më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë, të cilat sjellin uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë edhe ulje të konsumit të energjisë. Shpenzimet për energjinë elektrike janë rritur edhe për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos për ata operatorë që administrojnë edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Për shoqëritë, për të cilat burimi i financimit të investimeve janë kreditë, kosto e kredisë zë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos. Edhe shpenzimet e amortizimit zënë një pjesë të rëndësishme në këtë total. Hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve do të bënte të mundur uljen e këtyre shpenzimeve. Planet për menaxhimin e aseteve nënkuptojnë shërbim me kosto më të ulët e me risk të vogël të operimit e zotërimit të aseteve gjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së tyre duke patur parasysh arritjen e standardeve të shërbimit për konsumatorët.

Burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK është arkëtimi i të ardhurave që realizohen nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura për konsumatorët në zonën e tyre të juridiksionit. Në vitin 2014 niveli mesatar i arkëtitimit në sektor arriti 91%, tendenca ka qenë pozitive pasi niveli i arkëtitimit është rritur rreth 11% krahasuar me një vit më parë. Sektori është pranë objektivit strategjik (92%) të këtij treguesi dhe ka tejkaluar objektivin e performancës së mirë të ERRU. Përgjithësisht shoqëritë gjatë këtij viti kanë treguar më shumë vëmendje në drejtim të arkëtitimit të të ardhurave, por edhe deklarimi i qeverisë për të mos lejuar përfitim të shërbimeve pa i paguar ato, ka sjellë rritjen e tyre. Megjithatë, për shumë shoqëri arkëtimi i borxheve të këqija vazhdon të jetë problematik.

Një tregues tjetër që shënon rritje gjatë viteve të fundit është niveli i matjes. Ky tregues i ndihmon operatorët të operojnë me të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e prodhuar, faturuar dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga ky faturim. Për vitin 2014 niveli i shërbimit të matur në sektor ka arritur në 61.2% dhe tendenca e këtij treguesi është pozitive. Krahasuar me vitin 2012, niveli i matjes në vitin 2014 është rritur rreth 6%. Megjithatë, niveli 65% i objektivit të strategjisë kombëtare për sektorin nuk është arritur. Sektori është larg nivelit 85% të objektivit për performancë të mirë të vendosur nga ERRU.

Me gjithë përmirësimet në këtë drejtim, momentalisht niveli i faturimit aforfe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Shoqëritë deri në fund të vitit 2010 duhet të kishin përfunduar instalimin e matësve për gjithë klientët jo familjarë, por rezultatet tregojnë se në nivel sektori 23% e klientëve jo familjarë i përkasin ende shërbimit aforfe. Në sektor,

një numër i kufizuar operatorësh kanë instaluar matësit për të gjithë klientët, pjesa më e madhe ofron shërbim të matur dhe të pamatur, por ka edhe shoqëri të cilat pothuajse nuk ofrojnë shërbim të matur për konsumatorët. ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën në lidhje me pajisjen me matës të konsumatorëve si dhe ka kërkuar që të përfundojë pajisja me matës e konsumatorëve jo familjarë si dhe të gjithë lidhjet e reja t'i përkasin shërbimit të matur. Për ERRU, eliminimi i praktikës "aforfe" dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësive individual dhe në prodhim duhet të jetë në fokus të punës së operatorëve. Uji pa të ardhura, është një tregues i cili të paktën në tre vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira dhe përbën shqetësimin kryesor në sektor. Niveli i humbjeve në sektor është 67.2% e ujit të prodhuar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, përveç se niveli i lartë i humbjeve nuk gjeneron të ardhura rrit edhe koston, duke ndikuar negativisht në qëndrueshmërinë financiare të operatorëve.

Duke e konsideruar hartimin e balanceve të ujit si një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura, ERRU vazhdimisht i ka sugjeruar shoqërive UK hartimin e tij. Në vitin 2013 rregullatori përgatiti Modelin e Bilancit të Ujit dhe kërkoi plotësimin e tij të detyrueshëm nga të gjitha shoqëritë. Analiza e humbjeve bazuar në Bilancin e ujit tregon se humbjet menaxheriale janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, pra përveçse një sistemi të amortizuar, niveli i lartë i humbjeve është rezultat i një menaxhimi jo të mirë të shoqërive. Kjo situatë shtrihet para të gjithë shoqërive marrjen e masave urgjente duke filluar me evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme, rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimit, vendosjen e matësive në prodhim, matësive të bilancit dhe ato në shpërndarje për të njohur situatën reale të humbjeve.

ERRU ka vlerësuar performancën e operatorëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve mbi bazën e analizës dhe monitorimit të vazhdimësisë së shërbimit si dhe cilësisë së ujit të pijshëm. Në vitin 2014 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2013. Konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 12.1 orë në ditë. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit. Megjithatë tendenca e këtij treguesi është pozitive, nivelet e objektivit të performancës së mirë të ERRU dhe të strategjisë së sektorit nuk janë arritur. Shkalla e furnizimit me ujë edhe gjatë vitit 2014 varion nga 4 - 24 orë ujë në ditë. Operatorët që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur janë vetëm Sh.a. UK Korçë, Sh.a. UK Pogradec dhe Sh.a. UK Librazhd. Pjesa më e madhe e operatorëve ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar.

Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve nuk është në nivel të mirë dhe reflektohet në mos furnizimin e vazhdueshëm të klientëve me ujë të pijshëm dhe me presionin e duhur. ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. ERRU gjithashtu kërkon që shoqëritë e licencuara të zbatojnë procedura të përshtatshme që konsumatorët të mbahen të informuar lidhur me cilësinë e furnizimit me ujë dhe riskun e ndotjes.

Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime



Metodologjia e analizës së performancës

Në këtë pjesë të raportit analizohet dhe vlerësohet performanca individuale e shoqërive ujësjiellës kanalizime për vitin 2014 si dhe ecuria e tyre që nga viti 2012, duke identifikuar shoqëritë me performancë të mirë dhe ato me performancë të dobët si dhe shoqëritë me progresin më të mirë. Përpara analizës dhe paraqitjes së rezultateve të performancës po bëjmë një përshkrim të metodës së përdorur për vlerësim.

Treguesit kryesorë të performancës

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjiellës kanalizime bazohet në treguesit kryesorë të performancës (TKP) të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare, në përzgjedhjen e TKP përparësi u është dhënë atyre treguesve që vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve. Fillimisht është vlerësuar performanca individuale e çdo shoqërie e më pas janë krahasuar nivelet e arritura ndërmjet e tyre. Këta tregues janë:

TKP	Përshkrimi
1 – Mbulimi i Kostove O&M	Pjesa e kostove operative dhe mirëmbajtjes (përfshirë amortizimin dhe kostot kapitale) që mbulohen nga të ardhurat.
2 – Mbulimi i Kostos Totale	Pjesa e kostove totale për shërbimet e ofruara që mbulohen nga të ardhurat e shoqërisë.
3 – Norma e Arkëtimit	Raporti ndërmjet të ardhurave të arkëtuara dhe shumës së faturuar ndaj klientëve.
4 – Efienca e Stafit	Numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhjeve U&K.
5 – Uji pa të Ardhura	Pjesa e ujit të prodhuar që nuk i faturohet klientëve.
6 – Niveli i Matjes	Pjesa e lidhjeve me matës (numri i klientëve) si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të lidhjeve (klientëve).
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	Orët mesatare të furnizimit me ujë në ditë.
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm*	Pjesa e testeve për cilësinë e ujit të cilat përmbushin standardet
9 – Mbulimi me Kanalizime	Pjesa e popullsisë brenda zonës së shërbimit të një shoqërie së cilës i ofrohet shërbim kanalizimi, por jo domosdoshmërisht trajtimi i ujërave të ndotura.
10 – Perceptimi Rregullator	Është vlerësimi i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kuadrin rregullator.

Tabela 2. Pasqyra e treguesve kryesorë të performancës 2014

Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimit më të rëndësishme të punës së operatorëve duke na dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për nivelin e ofruar të shërbimeve. Niveli i arritur dhe përmirësimi i disa treguesve ndikohet jo vetëm nga faktorë të brendshëm si përmirësimi i menaxhimit, por edhe nga faktorë të jashtëm si investimet nga Qeverisja Qendrore, grantet e donatorëve etj. Për tregues si norma e arkëtimit, efienca e stafit, uji pa të ardhura si dhe mbulimi i kostove, përpjekjet e brendshme të shoqërive luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e tyre. Por për tregues si niveli i matjes apo mbulimi me shërbimet e kanalizimeve nivelet e arritura nuk varen vetëm nga puna e ofruesve të shërbimit, pasi për të rritur nivelin e tyre kërkohen investime kapitale. ERRU do të analizojë dhe vlerësojë performancën e shoqërive duke mbajtur parasysh ndikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, duke u bazuar dhe në një analizë më të detajuar përse i përket faktorëve të brendshëm që janë direkt të lidhura me përmirësimin e menaxhimit.

Lidhur me treguesin "Norma e arkëtimit" për vitin 2014, ERRU në këtë raport do të kryejë një analizë më të detajuar të situatës lidhur me mbulimet e kostove O&M si dhe të kostove totale me arkëtimet. Mbulimi i kostove të shoqërisë me të ardhurat nga faturimi është një tregues i rëndësishëm, por mbulimi i tyre me të ardhurat nga arkëtimi merr një rëndësi më të madhe pasi ka të bëjë direkt me atë çka hyn në buxhetin e shoqërisë e me të cilën lidhet pavarësia ekonomike dhe aftësia e tij paguese. Edhe përse i përket treguesit "Efienca e stafit" do bëhet një analizë më e thelluar e kostove të punës dhe efekti i ndryshmit të këtij indikator në këto kosto. Në analizën e treguesit "Mbulimi i kostove totale" do të pasqyrohet

se si shkojnë kostot për 1m3 ujë të prodhuar dhe kostot për 1m3 ujë të faturuar dhe efekti në kosto të tyre.

Gjithashtu bazuar në bilancin e ujit të detajuar që shoqëritë UK tashmë periodikisht raportojnë pranë ERRU-se, do të paraqitet një analizë me të detajuar e humbjeve të ujit, duke theksuar dhe ndikimin që kanë humbjet e dukshme në totalin e humbjeve të shoqërisë, tregues ky i lidhur drejt për se drejti me aftësitë menaxheriale të shoqërive UK.

Perceptimi rregullator është një tregues tjetër i analizës, përmes të cilit vlerësohet bashkëpunimi i shoqërive në procesin rregullator duke mbështetur përpjekjet e ERRU për të krijuar një mjedis rregullator transparent dhe të qëndrueshëm.

* Siç është theksuar në Raportin e Performancës së vitit 2013, ERRU synonte që cilësia e ujit në vazhdim të vlerësohej tërësisht me të dhënat e marra nga ISHP duke garantuar jo vetëm informim të saktë, por edhe vlerësim real të shoqërisë në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm. Gjithashtu procedurat mbi testimin dhe raportimin në lidhje me cilësisë të ujit të pijshëm do të ndryshonin duke ju referuar standardit kombëtar të cilësisë së ujit të pijshëm. Me gjithë punën e bërë, monitorimi dhe raportimi mbi cilësisë të ujit të pijshëm sipas marrëveshjes të bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe ISHP nuk është arritur. Për këtë arsye edhe në këtë vit ky tregues nuk do të analizohet.

Grupet e shoqërive

Në mënyrë që vlerësimi krahasues i performancës ndërmjet shoqërive të jetë sa më real, ERRU ka vendosur që shoqëritë ujësjellës kanalizime të grupohen sipas numrit të lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm, si një mënyrë e mirë për të bërë dallimin ndërmjet shoqërive të mëdha dhe të vogla.

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup
Grupi 1	→ 15,000 lidhje ujësjellës	11
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës	11
Grupi 3	← 3,000 lidhje ujësjellës	25 ¹

Tabela 3. Grupi i shoqërive, Burimi informacionit: ERRU

¹ Shënim: Sha U Bradashesh nuk ka raportuar të dhëna. Numri i shoqërive të analizuar në këtë grup është 24.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndarja e 57 shoqërive sipas këtyre grupeve.

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve Konsumatore (U)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve Konsumatore (U)
Grupi 1			Grupi 3		
UK	Tiranë	176,122	UK	Peqin	2,884
UK	Durrës	73,044	UK	Himarë	2,807
UK	Vlorë	41,268	U	Divjakë	2,786
UK	Elber sh.p.k	30,229	U	Ura Vajgurore	2,710
UK	Fier	28,404	U	Bulqizë	2,684
UK	Shkodër	27,165	U	Bilisht	2,546
UK	Berat - Kuçovë	25,037	UK	Delvinë	2,366
UK	Kavajë	22,953	U	Novoselë	2,314
UK	Korçë	20,832	U	Shkodër Fshat	2,287
U	Elbasan Fshat	17,330	UK	Fushë Krujë	2,150
UK	Sarandë	16,218	U	Malësi e Madhe	2,093
Grupi 2			U	Orikum	1,898
UK	Pogradec	14,106	U	Çorovodë	1,761
UK	Lushnjë	10,716	UK	Ersekë	1,664
UK	Gjirokastër	9,238	U	Polican	1,600
UK	Lezhë	7,478	U	Tropojë	1,516
U	Korçë Fshat	5,988	U	Selenicë	1,506
U	Lushnjë Fshat	5,835	U	Has	1,361
U	Kurbin	5,742	UK	Mirditë	1,200
UK	Kukës	4,973	UK	Bashkia Pukë	1,117
UK	Librazhd	4,780	U	Këlcyrë	1,002
U	Patos	4,652	U	Vau i Dejës	911
UK	Rrogozhinë	4,128	UK	Libohovë	783
UK	Burrel	4,080	UK	Fushë Arrëz	560
UK	Mallakastër	4,012	UK	Rubik	534
U	Gramsh	3,949	UK	Pukë Fshat	523
UK	Krujë	3,574	UK	Krastë	413
UK	Tepelenë	3,537	U	Gjirokastër Fshat	132
UK	Peshkopi	3,426	U	Bradashesh	0
U	Përmet	3,287			

Tabela 4. Ndarja e shoqërive në tre grupe, Burimi i informacionit ERRU

Analiza e performancës në lidhje me objektivat e vendosur nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar, duke vendosur kështu kufijtë e performancës së pranueshme. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë; gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët.




Figura 2: Shembull i Grafikëve të Analizës së TKP-ve

Në tabelën 5 tregohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa grafiku i më poshtëm është një shembull i grafikëve të analizës së TKP

Key Performance Indicators		Objektivat e vendosur		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efiçenca e Stafit (numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje) ²	Grupi 1	≤ 4	≥ 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	≥ 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	≥ 15	≥ 15
5 – Uji pa të ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤ 8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%
9 – Perceptimi Rregullatorit		n/a	n/a	n/a
10. Water quality		n/a	n/a	n/a

Tabela 5. Objektivat e synuar për treguesit kryesorë të performancës

Renditja e Shoqërive Ujësjetës Kanalizime

Për të identifikuar performuesit më të mirë dhe më të dobët si dhe për të krahasuar performancën ndërmjet shoqërive, shoqëritë ujësjetës kanalizime renditen sipas vlerësimit të performancës së përgjithshme. Renditja e tyre bazohet në shumën totale të pikëve të grumbulluara nga analiza e detajuar e secilit TKP. Çdo treguesi i është caktuar një peshë specifike dhe pikët e dhëna pasqyrojnë performancën e shoqërisë kundrejt niveleve të objektivave të vendosura nga ERRU. Për vitin 2014 vlerësimi i performancës së përgjithshme bazohet në 8 nga 10 TKP-të.

Performancës së barabartë ose mbi nivelin e objektivit të synuar që është vendosur nga ERRU i jepen pikët maksimale. Për shumicën e treguesve, kur performanca është nën objektivin e synuar për performancë të mirë shoqëria vlerësohet vetëm me një pjesë të pikëve të përcaktuara. Për treguesit si efiçenca e stafit, uji pa të ardhura, norma e arkëtimit dhe cilësia e ujit të pijshëm, performanca e dobët penalizohet rëndë duke mos i dhënë asnjë pikë. Në këtë rast, vlerësimi me pikë bëhet nëse performanca aktuale është brenda kufirit të performancës së pranueshme.

² Për TKP Efiçenca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsisë më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

Saktësia dhe Besueshmëria e të dhënave

Monitorimi dhe vlerësimi i performancës duhet të bazohet në të dhëna të sakta, të besueshme, të grumbulluara në kohë, të cilat të mundësojnë një vlerësim dhe krahasim kuptimplotë të performancës së shoqërive. Të dhënat e përdorura për analizën e performancës janë marrë nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë Drejtorisë së Përgjithshme Ujësjetës Kanalizime (NJMB), e cila mbledh dhe përpunon të dhënat e raportuara nga shoqëritë. Pavarësisht kontrollit të të dhënave nga stafi i NJMB gjatë analizës së performancës së vitit 2014, përsëri janë konstatuar pasaktësi në të dhënat e raportuara. Gjatë vitit 2014, ERRU dhe NJMB kanë bashkëpunuar për të përmirësuar sistemin e raportimit dhe verifikimit të të dhënave, bashkëpunim i cili do të vazhdoje edhe në vitet në vazhdim.

Për ERRU, saktësia dhe besueshmëria e të dhënave merr një rëndësi të veçantë në realizimin e objektivave të saj të vendosura në ligj, për të patur një vendimmarrje sa më korrekte në lidhje me licencimin e operatorëve dhe vendosjen e tarifave, në monitorimin e arritjeve të synuara të performancës së këtyre shoqërive si dhe në përdorimin e stimuljeve dhe/ose masave administrative për të arritur këto objektiva. Në këtë kuadër ERRU në bashkëpunim me GLZ, ka nisur një projekt për krijimin e një "Sistemi të raportimit rregullator". Baza e krijimit të sistemit rregullator është zbërthimi i objektivave të vetë ligjit të ERRU-së dhe strategjisë ndërsektoriale 2011-2017 në tregues të matshëm. Sistemi i cili do të përdoret për raportim rregullator (SIGMA), në mbledhjen e të dhënave dhe në vlerësimin e tyre do të përdorë të njëjtën terminologji e metodikë të përdorur në praktikën ndërkombëtare (treguesit e IWA-s). Mënyra e vlerësimit të të dhënave, do të bazohet në një klasifikim me 3 nivele sipas shkallës së besueshmërisë dhe saktësisë së llogaritjes së tyre, me qëllim që saktësia e tyre të jetë e matshme, jo vetëm për ERRU-në por dhe për aktorët e tjerë në sektor. Testimi paraprak i sistemit ka rezultuar pozitiv dhe të dhënat historike që nga viti 2008 janë tashmë pjesë e këtij sistemi.

3.1.1 Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes

Një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie është "Mbulimi i kostove O&M". Ky tregues tregon se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen (pa kostot kapitale dhe të amortizimit). Në vitin 2014, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 122% nga 113.8% që ishte në vitin paraardhës. Gjatë 5 viteve rresht Sektori ka bërë progres në mbulimin e kostove të operimit & mirëmbajtjes.

Grupi i parë i shoqërive

Në grupin e parë, bëjnë pjesë shoqëritë më të mëdha ku treguesi "Mbulimi i kostove O&M" tashmë nuk duhet të jetë më problem, dhe duhet të synojnë drejt mbulimit të kostove totale. Megjithatë në këtë grup ka ende 3 shoqëri që kanë nivelin e mbulimit të këtyre kostove nën 100%.Niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 8 shoqëri, Sh.a. UK Tiranë (187%) Sh.a. UK Korçë (178%), Sh.a. UK Berat-Kuçovë (145%), Sh.a. UK Sarandë (138%), Elber SHPK (sot Elbasan Qytet Sha) (135%), Sh.a. UK Fier (129%), Sh.a. UK Shkodër (124%) dhe Sh.a. UK Vlorë (103%).




Figura 3. Mbulimi i kostove O&M për grupin 1

Për vitin 2014, në grupin e parë shoqëria me performancën më të mirë është Sh.a. UK Tiranë ku mbulimi i kostove të O&M është në nivelin 178%, ndërsa shoqëria me performancën më të dobët është Sh.a. U Elbasan Fshat, ku mbulimi i kostove O&M është 61%. Në kufijtë e performancës së pranueshme (në nivelet 80%-100%) janë dy shoqëri, Sh.a. UK Kavajë dhe Sh.a. UK Durrës respektivisht me 98% dhe 91%.

Krahasimi i niveleve të arritura në mbulimin e kostove O&M në vitin 2014 me ato të një viti më parë tregon se për 10 nga 11 shoqëritë e këtij grupi, niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes ka tendencë pozitive. Progresi më i madh është shënuar nga Sh.a. UK Sarande me (+37.1%). Përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi kanë arritur edhe Sh.a. UK Durrës me (+23.87%) që e ka ngritur këtë operator nga niveli i performancës së dobët në vitin 2013 në atë të performancës së pranueshme.

Tendencën më të madhe në rënie (-4.14 %), e ka Sh.a. UK Elbasan Fshat që e ka çuar në fund të klasifikimit. Mbajtja nën kontroll e kostove si dhe përmirësimi i treguesve të punës, veçanërisht rritja e nivelit të faturimit që sjell rritjen e të ardhurave, bën të mundur rritjen e shkallës së mbulimit të kostove. Nga ana tjetër ndryshimi i tarifave ka efektet e veta pozitive në drejtim të rritjes së të ardhurave nga faturimi. Kombinimi i drejte i këtyre tre elementeve, duke patur parasysh edhe përbalueshmërinë nga ana e konsumatorit, domosdoshmërisht sjell përmirësimin e këtij treguesi.

Grupi i dytë i shoqërive

Në vitin 2014, janë 10 shoqëri që kanë arritur të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%, pra renditen në shoqëritë me performancë shumë mirë. Performancën më të mirë në këtë grup në mbulimin e kostove të O&M e ka arritur Sh.a. UK Pogradec me (141%), e ndjekur nga Sh.a. U Peshkopi (132%), Sh.a. UK Lezhë (127%), Sh.a. UK Gjirokastrë (119%), Sh.a. U Burrel (114%), Sh.a. U Gramsh (112%), Sh.a. U Bilisht (107%), Sh.a. UK Lushnjë (106%), Sh.a. UK Krujë (104%), Sh.a. UK Librazhd (101%).

Referuar të dhënave të raportuara në Njësinë e Monitorimit Sh.a. UK Burrel dhe Sh.a. U Himarë rezultojnë se kanë performancën më të mirë të këtij treguesi në këtë grup. Mbulimi i kostove O&M për vitin 2014 është respektivisht (210%) dhe (185%). Por në fakt ky tregues nuk është real pasi ka të bëjë me raportim jo të saktë të dhënave nga këto shoqëri në Njësinë e Monitorimit, konstatuar nga verifikimi i pasqyrave financiare kontabël si dhe gjatë inspektimeve të ERRU. Sipas pasqyrave financiare të vitit 2014, rezulton se mbulimi i kostove O&M për Sh.a. U Burrel është (114%). Për Sh.a. UK Himarë diferencat janë konstatuar gjatë inspektimit të kryer nga ERRU pranë kësaj shoqërie. Sh.a. UK Himarë ende nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2014. Për këtë arsye edhe këtë vit Sh.a. UK Himarë nuk mund të jetë pjesë e analizës, ndërsa Sh.a. UK Burrel mbetet shoqëri me performancë të mirë, por jo në vendin e parë (ky koment vlen edhe për treguesin " Mbulimi i Kostos Totale").

Në kufirin e performancës së pranueshme është vetëm Sh.a. U Përmet me (86%) të mbulimit të kostove O&M. Theksojmë se kjo shoqëri kanë rënie krahasuar me vitin paraardhës me 9%.

Sh.a. U Patos vazhdon të jetë shoqëria me performancën më të dobët ku niveli i mbulimit të kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti është vetëm (23%). Përveç kësaj shoqërie, në grupin e shoqërive me performancë të dobët renditen edhe 8 shoqëri të tjera, Sh.a. UK Kukës (77%), Sh.a. U Shkodër Fshat (73%), Sh.a. U Lushnjë Fshat (66%), Sh.a. UK Tepelenë (52%), Sh.a. U Kurbin (52%), Sh.a. U K Rrogozhinë (51%), Sh.a. UK Mallakastër (48%) dhe Sh.a. U Korçë Fshat (43%).




Figura 4. Mbulimi i kostove O&M për grupin 2 në vitin 2014

Krahasuar me vitin 2013 nga 21 shoqëri të këtij grupi 12 shoqëri e kanë përmirësuar këtë tregues në vitin 2014 dhe 9 të tjera e kanë përkeqësuar atë. Përmirësim të dukshëm në rritjen e shkallës së mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes kanë bërë Sha U Shkodër Fshat me (+33.72%) dhe Sha U Biliisht me (+31.16 %). Në vitin 2014 Sh.a U Shkodër Fshat ka rritur të ardhurat me 26 milion krahasuar me vitin 2013 si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit. Aktualisht kjo shoqëri është bashkuar me Sh.a U Malësi e Madhe dhe popullsia e mbuluar me shërbim është rritur me 63%. Për Sh.a U Biliisht rritja e shkallës së mbulimit të kostos ka ardhur si rezultat i rritjes së ardhurave me 38% dhe uljes së kostove me 15%. Por edhe Sh.a UK Lezhë, Sh.a. U Gramsh, Sh.a. UK Lushnjë Qytet, Sh.a U Lushnjë Fshat kanë rritur nivelin e këtij treguesi me mbi 10%.

Sh.a. UK Pogradec për vitin 2013 ishte një eksperiencë pozitive në menaxhimin e aktivitetit dhe kryerjen e shërbimit si dhe në aplikimin e sistemit tarifar me blloqe, i cili beri të mundur rritjen e të ardhurave e për pasojë mbulimin e kostove.

Për këtë vit, megjithëse kjo shoqëri ka nivelin më të mirë të mbulimit të kostos O&M në grup, ka shënuar rënien më të madhe në mbulimin e kostove në grupin e dytë (-35%) krahasuar me një vit më parë.

Kjo rënie ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të shpenzimeve veçanërisht në zërat materiale e shpenzime të tjera, ndërsa të ardhurat janë pothuajse në të njëjtin nivel me ato të vitit 2013. Tendencë negative të ndjeshme ky tregues ka patur edhe për Sh.a. UK Tepelenë me (-18.3%).

Sh.a. UK Kruje dhe Sh.a. UK Librazhd, edhe pse renditen në shoqëritë me performancë shumë të mirë në mbulimin e kostove, këtë vit niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes është ulur respektivisht me (-8.43%) dhe (-8.97%).

Grupi i tretë i shoqërive

Në këtë grup, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për të mbuluar tërësisht kostot O&M është arritur vetëm nga tre shoqëri, Sh.a. UK Ersekë (140%), Sh.a. U Tropojë (130%) dhe Sh.a. U Bulqizë (103%). Gjithashtu edhe në zonën e performancës së pranueshme gjenden vetëm 3 shoqëri, Sh.a. UK Delvine (93%), Bashkia Puke UK (88%) dhe Sha UK Rubik (82%).

Nga 24 shoqëritë e marra në analizë në këtë grup, 18 prej tyre renditen nën vijën e kuqe, pra në brezin e performancës së dobët. Këto shoqëri janë; Sh.a. U Ura Vajgurore (77%), Sh.a. UK Peqin (76%), Sh.a. UK Fushë Krujë (69%), Sh.a. U Divjakë (66%), Sh.a. U Këlcyrë (59%), Sh.a. UK Fushë Arrëz (58%), Sh.a. UK Krastë dhe Sh.a. UK Mirditë (57%), Sh.a. U Novoselë (55%), Sh.a. UK Libohovë (48%), Sh.a. U Has (47%), Sh.a. U Vau i Dejës (44%), Sh.a. U Oriktum (42%), Sh.a. U Poliçan (41%), Sh.a. U Selenicë (49%) Sh.a. UK Pukë Fshat (28%). Rezultatet tregojnë se 9 prej këtyre shoqërive nuk arrijnë të mbulojnë as 50% të kostove O&M. Shoqëria me performancën më të dobët vazhdon të jete Sh.a. U Gjirokastrë Fshat, që mbulon vetëm 27% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.




Figura 5. Mbulimi i kostove O&M për grupin 3 në vitin 2014

Niveli i mbulimit të kostove O&M ka tendence pozitive për gjysmën e shoqërive dhe në gjysmën tjetër vërehet tendenca negative e këtij treguesi. Rritja më e madhe është shënuar nga Sh.a. U Tropojë me (+37.26%) dhe ecurinë negative më të madhe e ka Sh.a. UK Fushë Arrëz me (-16.50%). Për ecuri pozitive vlen të përmendet edhe Sh.a. UK Bulqizë me (+35.48%), Sh.a. UK Ersekë me (+26.37%) dhe Sh.a. Fushë Krujë me (+23.93%). Përmirësimi ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave pasi shpenzimet përgjithësisht kanë mbetur në të njëjtin nivel me atë të vitit të mëparshëm.

Rezultatet e analizës së mësipërme tregojnë se situata në këtë grup edhe pse është jo e kënaqshme, ka dhe ndryshime pozitive. Në vitin 2012 në këtë grup nuk ishte asnjë shoqëri që të mbulonte kostot O&M 100%, pra të vlerësohej me performancë shumë të mirë, ndërsa sot janë 3 shoqëri të tilla.

Sh.a. U Tropojë dhe Sh.a. U Bulqizë me rritjen e nivelit të mbulimit të kostos së operimit dhe mirëmbajtjes përkatësisht me (+37.26%) dhe (+35.48%) ka bërë që të ngjitin një shkallë më lart dhe të futen në performuesit më të mirë të grupit. Ndërsa për Sh.a. UK Delvinë ulja e nivelin e mbulimit të kostove me (-12.43%) krahasuar me vitin 2013, e ka zbritur nga performanca shume e mirë në atë të pranueshme.

Përfundime

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se shoqëritë UK kanë bërë përpjekje për rritur nivelin e mbulimit të kostove O&M, nivel i cili për vitin 2014 është 122% nga 114% që ishte vitin paraardhës. Nga 56 shoqëritë e analizuara, 21 shoqëri kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 7 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 28 shoqëri janë në nivelin nën 80%, 12 prej të cilave nuk mbulojnë as 50% të kostove O&M. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot dhe vazhdimësia e aktivitetit të tyre mbështetet nga subvencionimi i buxhetit të shtetit.

Një shoqëri e shëndoshë financiarisht duhet të ketë të gjithë treguesit e punës pozitiv (uji pa të ardhura, niveli i matjes, niveli i faturimit, efienca e stafit dhe efienca e energjisë) pasi të gjitha këto janë të lidhura me njëra tjetrën dhe secila prej tyre ka ndikim tek tjetra e përfundimisht treguesi final është bilanci financiar që për shumicën e operatoreve rezulton negativ.

ERRU vazhdon ta konsiderojë mbulimin tërësor të kostove O&M nga shoqëritë, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Ndryshimi i tarifave luan një rol të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave të shoqërisë dhe për rrjedhojë edhe në mbulimin e kostove. Vendosja e tarifave sa më të drejta kërkon vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer. Në zbatim të Metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, miratimi i rritjes së tarifave është i kushtëzuar me përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës. Në këtë mënyrë ERRU mbështet dhe stimulon ato shoqëri që bëjnë përpjekje për të përmirësuar efiençën operacionale dhe shërbimin ndaj klientëve.

3.1.2 Mbulimi i kostove totale

Ky tregues ka të bëjë me aftësinë e shoqërive UK që me të ardhurat e faturuara për shërbimet Ujësjellës Kanalizime të mbulojë kostot totale të saj. Në kushtet kur shumica e shoqërive UK nuk janë akoma në gjendje të mbulojnë kostot O&M, sektori është ende larg plotësimit të këtij treguesi.

Për vitin 2014 ky tregues është 87% nga 84% që ishte në vitin 2013. Ecuria e tij është pozitive gjatë disa viteve rresht tregon për përpjekje të vazhdueshme në drejtim të një menaxhimi sa më të mirë të situatës teknike e financiare të shoqërive në veçanti e të sektorit U&K në tërësi.

Në vitin 2014, objektivi strategjik (74%) dhe ai i synuar nga ERRU (80%) i këtij treguesi për sektorin është tejkaluar, që tregon një zhvillim edhe më pozitiv.

Grupi i parë i shoqërive

Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, niveli i mbulimit të kostos totale për shoqëritë e grupit të parë është i ndryshëm. Për vitin 2014 janë 7 shoqëri që renditen në nivelin e performancës së mirë me mbi 80% të mbulimit të kostove dhe konkretisht Sh.a. UK Tiranë (123%), Sh.a. UK Shkodër (106%), Elber sh.p.k. (sot Elbasan Qytet Sha) (105%), Sh.a. UK Berat-Kuçovë (103%), Sh.a. UK Fier (94%) Sh.a. UK Korçë (95%) si dhe Sh.a. UK Sarandë (82%).

Në brezin e performancës së pranueshme gjenden katër shoqëri Sh.a. UK Vlorë (65%), Sh.a. UK Durrës (65%), si dhe Sh.a. UK Kavajë (58%) si dhe Sh.a. U Elbasan Fshat me (57%).




Figura 6. Mbulimi i kostos totale për grupin 1 në vitin 2014

Në fund të klasifikimit vazhdon të jetë Sh.a. U Elbasan Fshat me (57%) e cila ka shënuar një rënie prej (-4.13%) krahasuar me vitin 2013.

Gjatë vitit 2014, edhe pse shumica e këtyre shoqërive janë në nivele të mira brenda tyre ka luhate pozitive dhe negative krahasuar me vitin 2013. Ecurinë më të mirë pozitive e ka shënuar Sh.a. UK Sarandë me (+20.9%), që e ka renditur këtë shoqëri nga niveli i performancës së pranueshme në atë të performancës së mirë me 82%. Ecuri pozitive kanë dhe Sh.a. UK Berat Kuçovë (+11.7%), Sh.a. UK Kavajë (+11.4%), Sh.a. UK Korçë me (+9.1) si dhe Elber sh.p.k (sot Elbasan Qytet Sha) me (+6.5%).

Ky tregues ka patur tendencë negative për katër shoqëri. Për Sh.a. UK Tiranë edhe pse është shoqëria me performancën më të mirë, niveli i mbulimit të kostos totale ka patur tendencë negative duke rënë me (-4.3%). Niveli i mbulimit të kostos totale është ulur për Sh.a. UK Fier me (-5.3%), Sh.a. U Elbasan Fshat (-4.13%), ndërsa për Sh.a. UK Shkodër rënia është e papërfillshme me (-0.17%).

Grupi i dytë i shoqërive

Në grupin e dytë, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është tejkaluar nga 8 prej 21 shoqëri të këtij grupi, ku Sh.a. UK Gjirokastrë me (112%) vazhdon të mbetet për disa vite rresht shoqëria me mbulim mbi 100%, e ndjekur nga Sh.a. Bilisht (100%), Sh.a. U Peshkopi (98%), Sha UK Lezhë (91%), Sha U Gramsh (88%), Sh.a. UK Librazhd (85%).




Figura 7. Mbulimi i kostos totale për grupin 2 në vitin 2014

Në nivelin e performancës së pranueshme në kufirin 50%-80% renditen 4 shoqëri, konkretisht, Sh.a. UK Lushnjë (74%) Sh.a. U Përmet (73%), Sh.a. UK Pogradec (70%), si dhe Sh.a. UK Kukës (54%).

Në kufirin e performancës së dobët janë 9 shoqëri, Sh.a. U Kurbin, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Tepelenë, Sh.a. UK Shkodër Fshat, Sh.a. UK Mallakastër, Sh.a. UK Rrogozhinë, Sh.a. U Korçë Fshat mbulimi i kostos totale arrin deri në 48%. Sh.a. U Patos vazhdon të renditet e fundit për të tretin vit radhazi me nivelin më të ulët të këtij treguesi (22%).

Gjatë vitit 2014 për 8 shoqëri ky tregues ka patur progres krahasuar me vitin 2013. Shoqëritë që kanë patur ecurinë më të mirë pozitive janë Sh.a. U Bilisht me (+29.59%), Sh.a. UK Shkodër Fshat me (+19.4%) si dhe Sh.a. U Gramsh me (+14.52%).

Për 10 shoqëri të këtij grupi tendenca ka qenë negative. Rënien më të madhe e ka shënuar Sh.a. UK Pogradec me (-14.86%), e cila nga një shoqëri që mbulonte 101.86% kostot totale në vitin 2013, në vitin 2014 ka arritur të mbulojë 87% të këtyre kostove. Në këtë rezultat ka ndikuar shlyerja e detyrimeve që lidhen me koston e kredive, të cilat vijnë në rritje nga viti në vit. Edhe për Sh.a. UK Përmet tendenca e këtij treguesi nuk ka qenë pozitive, niveli i mbulimit të kostos totale është ulur me (-8.47%). Kjo tendence negative ka bërë që dhe shoqëritë të zhvendosen nga vendet që kishin në klasifikimin e vitit 2013 dhe konkretisht Sh.a. UK Pogradec dhe Sh.a. UK Përmet nga performues shumë të mirë kanë kaluar në brezin e performancës së pranueshme. Gjithashtu tendenca negative e mbulimit të kostos totale me (-11.5%) për SHA UK Tepelene dhe (-7.07%) për SHA UK Krujë ka bërë që këto shoqëri të kalojnë nga performanca e pranueshme në atë të dobët, me mbulim kostosh nën 50%.

Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë janë 4 shoqëri që renditen mbi nivelin e objektivit të vendosur nga ERRU prej 80% për performancë të mirë dhe konkretisht Sh.a. U Ersekë (113%) që renditet në krye të listës, Sh.a. U Tropojë me (102%), Sh.a. UK Bulqizë me (89%) që ka ecurinë më të mirë në grup me +45% si dhe Sh.a. UK Delvine me (83.%) që ka shënuar një rënie të konsiderueshme me (-13.58%).

Në brezin e performancës së pranueshme renditen 5 shoqëri, Sha U Rubik (77%), Bashkia Pukë (69%), Sh.a. U Peqin (67%), Sh.a. U Ura Vajgurore (65%), Sh.a. UK Këlcyrë (57%), Sh.a. UK Divjakë (52%), Sh.a. UK Mirditë (51%).

Në brezin e performancës së dobët renditen 13 shoqëri, pra pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi nuk mbulojnë as 50% të kostos totale.

Nivelet më të ulta të mbulimit të kostos totale shënohen nga Sh.a. U Çorovodë me (28%), Sh.a. UK Selenicë (26%), UK Gjirokastër Fshat dhe Sh.a. UK Pukë Fshat (20%).




Figura 8. Mbulimi i kostos totale për grupin 3

Gjatë vitit 2014 pjesa më e madhe e shoqëritë të këtij grupi kanë bërë përpjekje për të përmirësuar këtë tregues. Niveli i mbulimit të kostos totale krahasuar me një vit më parë është përmirësuar nga 15 shoqëri, ndërsa për 9 shoqëri tendenca ka qenë negative.

Sh.a. UK Bulqizë ka ecurinë më të mirë në grup me një rritje të mbulimit të kostos totale me (+45%), duke përmirësuar ndjeshëm performancën. Në vitin 2013 kjo shoqëri bënte pjesë në shoqëritë me performancë të dobët, ndërsa në vitin 2014 në grupin e shoqërive me performancë të mirë. Kjo shoqëri ka bërë përpjekje si për të rritur të ardhurat edhe për të ulur kostot. Në vitin 2014 të ardhurat janë rritur me 18% dhe kostot janë ulur me 16%, krahasuar me një vit më parë. Përmirësim të ndjeshëm në mbulimin e kostove ka patur edhe Sh.a. U Peqin dhe Sha U Bashkia Pukë me 36.6% që ka bërë që këto shoqëri të kalojnë nga performanca e dobët në vitin 2013 në brezin e performancës së pranueshme në vitin 2014. Gjithashtu ky tregues ka patur tendencë pozitive edhe për Sh.a. U Tropojë me (+28%), Sh.a. U Ersekë (+18%), Sha UK Fushë Arrëz (+17.10%), Sha U Fushë Krujë (+16.10%), Sh.a. U Orikum (+10.42%), Sh.a. U Krastë 16.87%.

Niveli i mbulimit të kostos totale ka shënuar rënie të konsiderueshme, krahasuar me vitin 2013, për Sha U Ura Vajgurore (-17.51%), Sha UK Selenicë (-15.48%), dhe Sha UK Delvinë (-13.58%). Ky rezultat ka ardhur për arsye se në vitin 2014 këto shoqëri kanë rritur kostot e shërbimit si dhe kanë ulur nivelin e të ardhurave. Për shoqëritë e tjera ndryshimet pozitive apo negative janë më pak se 5%. Por gjithsesi, ky grup është ende shumë larg objektivit strategjik të mbulimit të kostove.

Përfundime

Niveli mesatar i mbulimit të kostove totale për sektorin UK në vitin 2014, si dhe ecuria e këtij treguesi tregojnë se shoqëritë UK janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbuluar me të ardhurat e tyre kostot e shërbimeve të ofruara. Analiza e performancës tregon se rezultatet më të mira të mbulimit të kostos totale janë arritur nga shoqëritë e mëdha ujësjellës kanalizime, ndërsa shumica e shoqërive të vogla vazhdojnë të varen nga burimet e jashtme financiare.

Edhe për këtë vit ruhet e njëjta strukture kostoje ku pjesën më të madhe në totalin e kosto e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit si dhe për disa shoqëri kostot e kredisë.

Shoqëritë duhet të bëjnë përpjekje për mbajtjen nën kontroll të kostove, por nga ana tjetër duhet të punohet shumë fort drejt reduktimit të humbjeve pasi përqindja e lartë e humbjeve reflektohet arkëtime të munguara nga ana e shoqërive. Këtë vit ERRU ka analizuar dhe dy tregues të tjerë dhe konkretisht "kosto për 1m³ ujë të prodhuar" dhe "kosto për 1m³ ujë të faturuar". Sa më i madh është hendeku midis këtyre dy treguesve aq më të larta janë humbjet.

Për vitin 2014 kosto për 1m³ ujë të prodhuar është 25 lek dhe kosto për 1 m³ ujë të faturuar është 79 leke. Krahasimi i këtyre shifrave flet qarte se vetëm 1/3 e ujit faturohet. Prandaj një menaxhim sa më i mirë i sistemit, hartimi i planeve të biznesit, studimi sa më i mirë i nevojave për ujë, ndërhyrja me investime në rrjetin UK duhet të bëjë që ky hendek të vijë duke u zvogëluar. Përmirësimi i tij do të bëjë që dhe kostot të ulen e për pasojë shoqëritë UK të jenë financiarisht më të forta. Një analize më e detajuar e këtyre humbjeve do të pasqyrohet në analizën e treguesit "ujë pa të ardhura"

Shoqëritë duhet të punojnë më shumë edhe në drejtim të evidentimit të saktë të klientëve, lidhjeve të paligjshme që do të çojë drejt faturimit të ujit të konsumuar.

ERRU do të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë të gjitha shoqëritë UK për rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve.

3.1.3 Norma e Arkëtimit

Norma e arkëtimit përfaqëson raportin e të ardhurave të arkëtuara ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Nëpërmjet këtij treguesi kuptojmë se sa efektive është një shoqëri për të garantuar likuiditetin e nevojshëm. Performanca në lidhje me normën e arkëtimit në thelb është funksion menaxherial. Për vitin 2014, norma mesatare e arkëtimit në sektorin ujësjellës-kanalizime është 91% nga 82% që ka qenë në vitin 2013. Ky tregues edhe pse është përmirësuar ndjeshëm ende nuk është në nivelin e objektivit të përcaktuar në Strategjinë Sektoriale të Shërbimit UK e cila për vitin 2014 është përcaktuar 92%.

Grupi i parë i shoqërive

Në grupin e parë, shoqëria me performancën më të mirë të këtij treguesi për vitin 2014 është Sh.a. UK Tiranë, e cila ka arritur të arkëtojë 111.09% si dhe Sh.a. U Elbasan Fshat me 102.39%. Megjithatë, duhet theksuar se ky nivel arkëtimi mbi 100% ka ardhur si pasoje e arkëtimit të faturave të prapambetura të periudhave të mëparshme. Niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është arritur edhe nga Elber Sh.p.k. (sot Elbasan Qytet Sha) me (93.37%), Sh.a. UK Korçë (92.99%), Sh.a. UK Berat-Kuçovë (84.48%) si dhe Sh.a. UK Durrës me (82.03%). Shoqëria me nivelin më të ulët të arkëtimit, pra edhe me performancën më të dobët është Sh.a. UK Shkodër me 67.9%.




Figura 9. Norma e arkëtimit për grupin 1 në vitin 2014

Rezultatet e arritura për arkëtimin e të ardhurave në vitin 2014, krahasuar me vitin 2013 për shoqëritë e këtij grupi tregojnë se ndryshimet pozitive kanë qenë në 10 shoqëri nga 11 që ka grupi i parë.

Niveli më i lartë i rritjes është regjistruar nga Elber sh.p.k. (sot Elbasan Qytet Sha) me +19.48%. Vetëm Sh.a. UK Sarandë ka pësuar një rënie të vogël krahasuar me vitin 2013 me (-1.52%). Siç shihet përmirësimi i këtij treguesi është regjistruar për një numër më të madh shoqëri të këtij grupi, gjë që ka sjell dhe efektin pozitiv në rritjen e nivelit të arkëtimit në rang sektori. Vlen të përmendet që në këtë grup nuk ka asnjë shoqëri në nivelin e performancës së dobët.

Grupi i dytë i shoqërive

Në grupin e dytë, 14 nga 21 shoqëri kanë arritur nivelin e normës së arkëtimit mbi 82% që është performanca më e mirë, 5 shoqëri janë në nivelet e performancës së mirë (në nivelet 60%-82%) dhe vetëm 2 shoqëri janë në nivelin e performancës së dobët (nën 60%) dhe konkretisht Sh.a. UK Himarë me (33.33%) dhe Sh.a. U Shkodër fshat me (57.01%). Performanca më e mirë i përket Sh.a. U Bilisht ku norma e arkëtimit është (104.92%), me një rritje prej 19.24% krahasuar me vitin paraardhës e ndjekur nga Sh.a. UK Librazhd me (99.62%) si dhe Sh.a. U Përmet me (95.59%).




Figura 10. Norma e arkëtimit për grupin 2 në vitin 2014

Krahasuar me vitin 2013, norma e arkëtimit për vitin 2014 për 19 nga 21 shoqëri të këtij grupi ka patur tendencë pozitive. Shoqëria me ecurinë më pozitive është Sh.a. U Lushnjë Fshat me një përmirësim prej 19.53%. Duhet theksuar se dhe Sh.a. UK Kukës ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi me +16.5%, gjë e cila ka bërë të mundur që shoqëria të kapërcejë nivelin e performancës së dobët. Për t'u përmendur janë edhe Sh.a. UK Tepelene e Sh.a. UK Rrogozhinë me përmirësim të normës së arkëtimit respektivisht me +17.58% dhe +16.8 %. Ky përmirësim ka bërë që të dyja shoqëritë të kalojnë nga niveli i performancës së mire në atë të performancës shumë të mirë.

Norma e arkëtimit është ulur për 2 shoqëri. Shoqëria që ka regjistruar rënien më të madhe të këtij treguesi me -7.86% është Sh.a. UK Burrel si dhe Sh.a. UK Pogradec me -3.96%. Megjithatë këto shoqëri vazhdojnë të jenë në grupin e performancës së mirë.

Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë, ku bëjnë pjesë 24 shoqëri, 18 prej tyre kanë tendence pozitive të treguesit "norma e arkëtimit". Për 10 shoqëri norma e tyre e arkëtimit në vitin 2014 është më e madhe se 82% pra në nivelin e performancës shumë të mirë, 12 shoqëri janë në nivelin e performancës së mirë (60-82%) dhe vetëm 2 shoqëri janë në nivelin e performancës së dobët nën 60%.

Shoqëria me performancën më të mirë është Bashkia Pukë me normë arkëtimi 126.52% e ndjekur nga Sh.a. UK Peqin me 113.55%, Sh.a. UK Erseke me 106.11%. Këto rezultate kanë ardhur si rrjedhojë e punës së mirë që është bërë për arkëtimin e debive edhe nga periudhat e mëparshme. Në nivelin e performancës së mire vlen të përmendet Sh.a. UK Fushe Arrëz, e cila ka normën e arkëtimit 78.66%, por ka një rritje prej +19.5% krahasuar me vitin 2013 që e ka nxjerrë këtë shoqëri nga niveli i performancës së dobët në atë të performancës së mirë.




Figura 11. Norma e arkëtimit për grupin 3 në vitin 2013

Edhe pse afërsisht 50% e shoqërive të këtij grupi janë në nivelin e performancës së mirë, me normë arkëtimi mbi 82%, theksojmë se dy prej tyre kanë rënie për vitin 2014, konkretisht Sh.a. UK Rubik me -21.48% dhe Sh.a. U Divjakë me -4.07% por gjithsesi mbeten në nivelin e performancës së mirë.

Në grupin e performancës së pranueshme 60%-82%, 3 shoqëri kanë rënie të nivelit të normës së arkëtimit krahasuar me vitin 2013 dhe konkretisht Sh.a. UK Fushe Kruje me (-22.19%), Sh.a. UK Libohove me (-11.94%) si dhe Sh.a. U Bulqizë me (-6.96 %). Shoqëritë me performancën më të dobët vazhdon të jetë Sh.a. U Tropojë me normë arkëtimi vetëm (36.04%) si dhe Sh.a. U Novosele me (56.37%).

Në vitin 2014, tendenca e përgjithshme e këtij treguesi në grupin e tretë ka qenë pozitive. Për shumicën e shoqërive 18 nga 24, norma e arkëtimit ka qenë më e lartë se një vit më parë. Mungesa e një menaxhimi të mirë ka bërë që niveli i normës së arkëtimit të bjerë për 5 shoqëri të këtij grupi. Gjithsesi ashtu si në dy grupet e tjera mund të themi që është punuar në përgjithësi mirë për përmirësimin e këtij treguesi.

Përfundime

Norma mesatare e arkëtimit për sektorin në fund të vitit 2014 shënoi një progres të ndjeshëm (91%) kundrejt nivelit të arkëtimit në fund të vitit 2013 (82%). Rreth 6% e arkëtimeve ka ardhur dhe si rezultat i arkëtimeve që shoqëritë kane bërë nga vitet e mëparshme, por dhe për këtë zë, gjatë vitit 2014 ka pasur një përmirësim të ndjeshëm, në krahasim me vitin 2013, ku këto arkëtime zinin vetëm 3% të vlerës total të arkëtimeve.

Në vitin 2014 për 47 shoqëri është vërejtur një përmirësim i normës së arkëtimit gjë që ka sjellë një përmirësim të performancës financiare të sektorit. Megjithatë ka ende shoqëri kryesisht të vogla që janë dobët në këtë drejtim. Në 8 shoqëri konstatohet që ka rënie të normës së arkëtimit, dhe në 2 të tjera është ruajtur pothuajse i njëjti nivel i arkëtimit.

ERRU thekson se burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK janë të ardhurat nga aktiviteti, prandaj pavarësisht nga arsyet objektive dhe subjektive menaxherët e shoqërive duhet të punojnë për mirë administrimin e të ardhurave. Arkëtimi në kohë i detyrimeve nga ana e operatorit ka ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e tij paguese që do të thotë në shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve.

Mbulimi i kostove të shoqërisë me të ardhurat nga faturimi është një tregues i rëndësishëm, por mbulimi i tyre me të ardhurat nga arkëtimi merr një rëndësi më të madhe pasi ka të bëjë direkt me atë çka hyn në buxhetin e shoqërisë me të cilën lidhet pavarësia ekonomike dhe aftësia e tij paguese.

Për vitin 2014 si sektor mbulimi i kostove totale me faturimin është në nivelin e 87%, ndërsa mbulimi me të ardhurat e arkëtuara është 75%. Për të krijuar një ide më të qarte, në mënyrë tabelore, është paraqitur situata e mbulimit të kostove totale me arkëtime dhe faturime për grupin e parë për vitin 2014.

Shoqëritë	Mbulimi i kostove total me faturim	Norma e arkëtimit	Mbulimi i kostove totale me arkëtime
Tiranë UK Sh.a	111%	111.09	123%
Elber UK sh.p.k	105%	93.37	98%
Berat_Kuçovë UK Sh.a.	101%	84.48	86%
Korçë UK Sh.a.	93%	92.99	86%
Shkodër UK Sh.a.	106%	67.9	72%
Fier UK Sh.a.	94%	74.74	70%
Sarandë UK Sh.a.	81%	73.62	60%
Elbasan (F) U Sh.a.	50%	102.39	52%
Vlorë U Sh.a.	65%	71.05	46%
Kavajë UK Sh.a.	55%	80.47	44%
Durrës UK Sh.a.	62%	82.03	51%

Tabela 6. Mbulimi i kostove totale me arkëtime, Grupi i Pare

Shoqëritë me normë arkëtimi të lartë kanë dhe rritje të % së mbulimit të kostove O&M nga arkëtimet. Shoqëritë si Sh.a. UK Tirane dhe Sh.a. U Elbasan Fshat që kanë norme arkëtimi mbi 100% për arsye të arkëtimeve të prapambetura (përkatësisht 111.09% dhe 102.39%), kanë rritje në mbulimin e kostove. Për të gjithë operatorët e tjerë me normë arkëtimi nën 100% treguesi "mbulimi i kostove me arkëtim" ka tendence të uljes krahasuar me "mbulimi i kostove me faturim" dhe sigurisht që niveli i uljes varet nga % e normës së arkëtimit.

Duke qenë se tek grupi i parë, për shkak të madhësisë së operatorëve ky efekt duket më qarte, analiza më e detajuar e grupeve të tjerë nuk është paraqitur në raport. Por pavarësisht kësaj, e njëjta gjë mund të thuhet dhe për grupin e dytë e për më tepër të tretë, ku ekzistojnë probleme më të theksuara me nivelin e normës së arkëtimit. Edhe pse është punuar fort në drejtim të arkëtimeve gjë që reflektohet në të hyrat si sektor që janë rritur me +684000 mijë leke ose 13% me shume se viti 2013, ende në bilancet e shoqërive konstatohet se ka shumë debi të prapambetura.

Faturimi sistematik i të gjithë klientëve brenda zonës së tyre të juridiksionit, krijimi i lehtësirave për kryerjen e pagesave duke hapur zyra të kujdesit ndaj klientit lehtësisht të arritshme, ofrimit të mënyrave bashkëkohore të kryerjes së pagesave, identifikimi i klientëve problematikë dhe gjithashtu futja në përdorim e arkëtimit të detyruar ndihmojnë në përmirësimin e normës së arkëtimit. Një ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi është ofrimi i shërbimeve cilësore. Eksperiencat tregojnë se shoqëritë që ofrojnë shërbime cilësore kanë edhe normë arkëtimi të lartë dhe konsumatorët nuk hezitojnë të paguajnë edhe në se tarifat rriten.

3.1.4 Efiçenca e Stafit

Treguesi i përdorur për të vlerësuar efiçencën e stafit është numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhjeve të ujit. Që nga përkufizimi del qartë se dy janë faktorët që ndikojnë në këtë tregues: numri i lidhjeve të ujit dhe numri i stafit operues.

Efiçenca e stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK. Një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi sa më efektiv është përmirësimi i efiçencës operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit. Nga ana tjetër edhe shtrirja e madhe e shoqërisë bën që numri i punonjësve që kryejnë shërbimin të rritet. Duke marrë parasysh specifikat e operimit të shoqërive e shërbimit ERRU ka vendosur nivele të diferencuara objektivash për të tre grupet e shoqërive.

Kostot e personelit aktualisht zënë rreth 47% të kostove O&M të shërbimeve ujësjellës kanalizime. Nisur nga kjo, ky tregues merr rëndësi të veçantë prandaj edhe është përfshirë në listën e treguesve kryesorë të performancës të operimit dhe mirëmbajtjes. Në vitin 2014 niveli mesatar i punonjësve për 1000 lidhje për të gjithë sektorin është 8.9 nga 9.5 që ishte në fund të vitit 2013. Ky tregues është përmirësuar me 0.93 pikë % dhe në këtë përmirësim ka ndikuar ulja e numrit të punonjësve si dhe rritje e numrit të lidhjeve gjatë vitit 2014.

Grupi i parë i shoqërive

Për grupin e parë, ERRU ka përcaktuar si nivel performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, të performancës së dobët mbi 6 punonjës për 1000 lidhje dhe atë të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje.

Në vitin 2014 brenda kufirit të pranueshëm të performancës janë renditur 4 nga 11 shoqëritë e këtij grupi konkretisht Sh.a. UK Shkodër me 4.4 punonjës për 1000 lidhje, Sh.a. UK Vlorë me 5.17, Sh.a. UK Berat-Kuçovë me 5.51 si dhe Sh.a. UK Durrës me 5.64 punonjës. Në nivelin e performancës së dobët (mbi 6 punonjës për 1000 lidhje) janë 3 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët vazhdon të mbetet Sh.a. U Elbasan Fshat me 10.35 punonjës për 1000 lidhje edhe pse krahasuar me vitin 2013 kjo shoqëri ka bërë përmirësimin me të dukshëm me (-2.49 punonjës për 1000 lidhje).

Në nivelin e performancës shumë të mirë (nën 4 punonjës për 1000 lidhje) krahas Sh.a. UK Korçë dhe Sh.a. UK Sarandë që kanë qenë në këtë nivel dhe në vitin 2013, janë bashkangjitur duke përmirësuar këtë tregues dhe shoqëritë Elber sh.p.k. (sot Sh.a. Elbasan Qytet) dhe Sh.a. UK Tiranë përkatësisht me 3.53 dhe 3.67 punonjës për 1000 lidhje.




Figura 12. Efienca e stafit për grupin e parë në vitin 2013

Krahasuar me vitin 2013, për të gjitha shoqëritë e këtij grupi ky tregues ka patur ndryshime të vogla si pozitive ashtu edhe negative. Tendenca ka qenë pozitive për Elbasan fshat me - 2.49, Elber sh.p.k. (sot Elbasan Qytet Sha) me -1.75 si dhe për Sh.a. UK Tiranë, Sh.a. UK Vlorë dhe Sh.a. UK Berat-Kuçovë ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me më pak se 1 person për 1000 lidhje.

Ndërmjet shoqërive që kanë përkeqësuar treguesin efienca e stafit me rritje më pak se 1 punonjës për 1000 lidhje janë Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Shkodër, Sh.a. UK Durrës dhe Sh.a. UK Kavajë ku duhet theksuar që për këto shoqëri numri i punonjësve në mbyllje të vitit 2014 është më i madh se ai në çelje të vitit. Për sa i përket numrit të lidhjeve të ujit pothuajse është në të njëjtat nivele të vitit 2013, pra me ndryshime të vogla me një efekt të pandjeshëm në këtë tregues.

Grupi i dytë i shoqërive

Për grupin e dytë niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.

Për vitin 2014 dhjetë shoqëri janë në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi. Me përjashtim të Sh.a. UK Kruje ku ky tregues është përkeqësuar me (-0.75) për 9 shoqëritë e tjera tendenca ka qenë pozitive. Tendenca pozitive e këtij treguesi për Sh.a. U Tepelene, Sh.a. U Lushnjë fshat si dhe Sh.a. U Peshkopi ka bërë që këto shoqëri të kalojnë nga niveli i performancës së dobët në nivelin e performancës së pranueshme.

Grafiku tregon se gjashtë shoqëri kanë performancë të dobët (ato janë renditur mbi vijën e kuqe të nivelit të performancës së dobët) ku Sh.a. U Patos rezulton me 24.16 punonjës për 1000 lidhje e ndjekur nga Sh.a. U Kurbin me 22 punonjës për 1000 lidhje.

Në vitin 2014, pesë shoqëri kanë arritur nivelin e performancës së mirë të përcaktuar nga ERRU. Sh.a. UK Pogradec, është shoqëria me performancën më të mirë me 4.1 punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë janë edhe Sh.a. UK Burrel, Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. UK Rogozhinë dhe Sh.a. UK Lushnjë me respektivisht 5.21, 5.25, 5.32 dhe 5.85 punonjës për 1000 lidhje.

Duhet theksuar se të gjitha këto shoqëri kanë tendencë të përmirësimit të këtij treguesi. Sh.a. UK Lushnjë dhe Sh.a. U Burrel kanë përmirësimin më të ndjeshëm me (-1.29) punonjës dhe (-1.12) që ka sjelle kalimin e këtyre shoqërive nga kategoria me performancë të pranueshme në grupin e performancës së mirë.




Figura 13. Eficienca e stafit për grupin e dytë në vitin 2013

Krahasuar me vitin 2013, për 17 nga 21 shoqëri të këtij grupi vihen re ndryshime pozitive për këtë tregues. Ndryshimin më të madh pozitiv e ka Sh.a. UK Shkodër fshat ku eficienca e stafit është përmirësuar ndjeshëm (numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me 15.07 punonjës). Në këtë përmirësim ka ndikuar bashkimi i dy operatorëve në një të vetëm.

Përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi ka dhe Sh.a. U Lushnjë fshat si dhe Sh.a. UK Tepelene respektivisht me (-4.01) dhe (-3.85) punonjës për 1000 lidhje. Sh.a. UK Kurbin ka përkeqësuar këtë tregues duke rritur numrin e punonjësve për 1000 lidhje me (1.69) punonjës.

Grupi i tretë i shoqërive

Për grupin e trete niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje. Në grupin e tretë, 10 nga 24 shoqëri kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është Sh.a. UK Erseke me (5.81) punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin

e performancës së mirë renditen edhe Sh.a. U Selenicë, Sh.a. UK Libohovë Sh.a. UK Fushë Arrëz, Sh.a. U Delvinë, Sh.a. UK Fushë Krujë, Sh.a. U Orikum, Sh.a. U Vau i Dejës, Bashkia Pukë dhe Sh.a. UK Rubik.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 9 shoqëri. Edhe pse ka përmirësimin më të ndjeshëm të këtij treguesi me (-20.72 punonjës) e fundit në këtë listë vazhdon të mbetet Gjirokastrë Fshat me 55.18 punonjës për 1000 lidhje, nivel i papranuar punonjësish për faktin që kjo shoqëri u shërben 200 klientëve me shërbimin e furnizimit me ujë dhe ka 11 punonjës gjithsej.

Gjithashtu dhe Sh.a. UK Pukë Fshat, Sh.a. U Has, Sh.a. U Poliçan dhe Sh.a. U Skrapar përkatësisht me 31.6, 24.98, 24.45 dhe 23.42 punonjës për 1000 lidhje dallohen për performancë të dobët. Numri i punonjësve në këto shoqëri është 4-5 herë më i lartë sesa ai i shoqërisë më të mirë në këtë grup.




Figura 14. Efienca e stafit për grupin 3 në vitin 2013

Në këtë grup, 50% e shoqërive e kanë përmirësuar këtë tregues edhe pse në nivele të vogla por gjithsesi këto përmirësime gjykohen të rëndësishme duke pasur parasysh peshën e kostos së personelit në totalin e kostove. Pas Gjirokastrë fshat ndryshimin më të dukshëm pozitiv me (-3.53) punonjës e ka Sh.a. U Bulqizë e cila e ka renditur këtë operator nga niveli i performancës së dobët në atë të performancës së pranueshme.

Për sa i përket zonës së kuqe vazhdojnë të mbeten ato shoqëri që kanë qenë dhe në vitin 2013. Ka përkeqësim të ndjeshëm në këtë kategori për Sh.a. U Skrapar me (+4.68) dhe Sh.a. UK Peqin me (+2,67) punonjës për 1000 lidhje. Theksojmë se dhe Sh.a. U Has ka përkeqësim të këtij treguesi me (+2.21) punonjës për 1000 lidhje krahasuar me vitin e mëparshëm 2013 ku kishte përmirësimin më të ndjeshëm në grup me (-7.1) punonjës ku faktor kryesor ka qenë rritja e numrit të klientëve.

Përfundime

Përmirësimi i efikasitetit operacionale është i domosdoshëm për arritjen e standardeve më të mira të shërbimit ku përmirësimi i efikasitetit të stafit është një element i rëndësishëm. ERRU e ka përzgjedhur këtë tregues si një ndër treguesit kryesore të vlerësimit të performancës edhe për arsye të ndikimit që ai ka në kostot e shërbimit dhe për rrjedhojë edhe në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive.

Në mbyllje të vitit në rang sektori ka një ulje të numrit të punonjësve. Të dy variablat prej të cilave del ky tregues kanë patur përmirësim krahasuar me vitin 2013, numri i lidhjeve në fund të vitit 2014 është 18300 më shumë se fundviti 2013 dhe po kështu dhe numri i punonjësve me kohë të plotë është ulur me 195 punonjës. Por nga ana tjetër brenda 57 shoqërive ka dhe tendenca të rritjes së numrit të punonjësve shpesh dhe të pajustificuara. Vendosija e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të përkushtuar shoqëruar me një organizim të brendshëm të mirë si dhe me zgjerim dhe evidentimin të sakte të klientëve, domosdoshmërisht do të sjellë arritjen e objektivave të përcaktuara nga ERRU lidhur me efikasitetin e stafit. Gjithashtu dhe kostot e punës në kostot O&M përsëri zënë rreth 47%. Për vitin 2014 edhe pse numri i punonjësve me kohë të plotë është ulur, shpenzimet për paga nuk kanë pësuar ulje.




Figura 15. Efikasiteti i stafit dhe lidhja me kostot e punës për shoqëritë UK

Brenda 55 shoqërive, ato që kanë rritur ndjeshëm numrin e lidhjeve janë Sh.a. UK Tirane me (+10151) lidhje, Sh.a. U Elbasan fshat me (+2636) lidhje, Sh.a. U Bilisht me (+619) lidhje, Sh.a. UK Vlore me (+1570) lidhje, Sh.a. UK Fier me (+550) lidhje, Elber sh.p.k. (sot Elbasan Qytet Sha) me (+597) lidhje dhe Sh.a. UK Lezhe (+400) lidhje, etj. Vetëm 12 shoqëri kane patur ulje të numrit të lidhjeve ku mund të veçojmë Sh.a. UK Peqin me (-347) lidhje, Sh.a. U Skrapar me (-277) lidhje, Sh.a. U Bulqizë me (-166) lidhje si dhe Sh.a. UK Berat Kuçovë me (-134) lidhje.

Përsa i përket numrit të punonjësve me kohë të plotë nga ndërmarrja rreth 50% e shoqërive kanë patur përmirësime edhe pse në pjesën më të madhe të tyre në shifra minimale.

Uljen më të madhe të numrit të punonjësve e ka Sh.a. UK Tirane me (-74) punonjës duke vazhduar me Elber sh.p.k., (sot Elbasan Qytet Sha) me (-21) punonjës, Sh.a. U Shkodër fshat me (-20) punonjës ku ka patur efektin pozitiv bashkimi i dy shoqërive në një të vetme si dhe Sh.a. UK Lushnjë me (-22) punonjës. Rreth 14 shoqëri kanë lëvizje negative dhe pozitive ne + ose - deri ne 1 punonjës.

Rritjen më të ndjeshme të numrit të punonjësve e ka Sh.a. UK Durrës me (+25) punonjës kjo dhe për faktin e vënies në punë të ITUN, Sh.a. UK Kavajë me (+8) punonjës si dhe Sh.a. UK Kruje me (+6) punonjës.

Siç e theksuam dhe më lart shpenzimet për paga si sektor janë në të njëjtin nivel me vitin 2013. Kjo nuk do të thotë që të gjitha shoqëritë nuk kane patur ulje të kostove pasi brenda tyre ka dhe shoqëri të cilat i kanë ulur kostot e punës. Këtu mund të veçojmë Sh.a. UK Durrës me (-24945) mijë lekë, Sh.a. UK Fier me (-7635) mijë lekë dhe Sh.a. UK Lushnjë (-7021) mijë lekë, si dhe rreth 19 shoqëri të tjera me ulje më të vogla.

Nuk mund të themi për Sh.a. UK Tirane të njëjtën gjë pasi ulja e numrit të punonjësve është shoqëruar me rritje të kostove të punës me (+25937) mijë lekë ose 4% më shumë krahasuar me vitin 2013. Rritje të ndjeshme ka pësuar dhe Sh.a. UK Kruje me (21%), Sh.a. UK Berat Kuçovë me (10%), Sh.a. U Bilisht me (21%), Sh.a. U Peqin (18%) si dhe Sh.a. U Has (16%).

Përfundimisht mund të themi që në përgjithësi ulja e numrit të stafit për 1000 lidhje shoqërohet me ulje të kostove por efektet pozitive nuk janë aq të ndjeshme pasi shoqëritë bëjnë dhe rishikim të pagave pothuajse të përvitshëm dhe motivohen e vlerësohen me pagë më të mirë punonjësit më të mirë.

Në përgjithësi nga analiza e këtij treguesi për të 57 shoqëritë, vihet re se niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë sipas grupeve, është arritur vetëm nga 19 shoqëri. Për 39 shoqëri vihet re që ka një tendence pozitive në drejtim të këtij treguesi dhe vetëm 18 shoqëri kryesisht të vogla janë në zonën e kuqe, pra performojnë dobët

Shoqëritë e mëdha arrijnë më lehtë nivele të larta të efikasitetit të stafit se sa shoqëritë më të vogla. Gjithsesi analiza e mësipërme tregon se edhe sistemet më të vogla mund të performojnë si duhet kur kanë një menaxhim të mirë.

3.1.5 Uji pa të ardhura

Sasia e ujit të prodhuar e cila nuk i faturohet konsumatorëve, për rrjedhojë nuk gjeneron as të ardhura, përfaqëson atë tregues të quajtur "Uji pa të ardhura".

Gjatë vitit 2014, sasia e ujit të prodhuar nga 57 shoqëri është 271 517 mijë m³, ndërsa sasia e ujit që nuk gjeneron të ardhura është 183 352 mijë m³, e shprehur në përqindje mesatarja e ujit pa të ardhura në sektor për këtë vit është 67.2%. Niveli i këtij treguesi, pothuajse i pandryshuar në katër vitet e fundit, vazhdon të mbetet shqetësim për sektorin UK dhe ERRU pasi nuk ka pësuar rënie të ndjeshme dhe vazhdon të qëndrojë larg objektivit të vendosur për këtë tregues.

Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (administrative), të cilat përbehen nga humbjet në lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje (në prodhim dhe tek konsumatorët) si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Analiza e bërë mbi "bilancet e ujit" për vitin 2014 tregoi se në disa shoqëri vlera e humbjeve të dukshme zë pjesën më të madhe të humbjeve të përgjithshme, angazhimi për reduktimin i tyre do të ndryshonte ndjeshëm situatën ekonomike të shoqërive. Nisur nga kjo, edhe analiza për këtë tregues është mbështetur në humbjet e përgjithshme dhe në ato të dukshme.

Grupi i parë i shoqërive

Në këtë grup, operatori Sh.a. UK Korçë, me nivelin 25,18 % të këtij treguesi vazhdon të jetë operatori me performancën më të mirë gjatë tre viteve të fundit.

Përkeqësim të këtij treguesi, në krahasim me vitin 2013, kanë pësuar operatorët Sh.a. U Elbasan Fshat me 4,97%, Sh.a. UK Vlorë me 3,36 %, Sh.a. UK Durrës me 1,48% dhe Sh.a. UK Berat-Kuçovë me 2,74%, duke u larguar akoma më tepër kufirit të performancës së mirë. Operatori Sh.a UK Kavajë ka rritur këtë tregues me 11,75 % si pasojë e rënies së nivelit të faturimit, rritjes së lidhjeve të paligjshme në transmetim si dhe nga humbjet e ujit në rrjet shpërndarës si pasojë e amortizimit.

Nga 11 shoqëri të grupit të parë, 8 prej tyre vazhdojnë të jenë me performancë të dobët, me nivelin e ujit pa të ardhura mbi 50%. Tendencë në ulje për këtë tregues, sikurse shihet edhe nga grafiku, kanë paraqitur operatorët Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Shkodër, Sh.a. UK Sarandë. Nga analiza e humbjeve, për Sh.a. UK Korçë, vërejmë se humbjet administrative zënë 80% të humbjeve të përgjithshme ose 658 mijë m³, kjo si pasojë e pasaktësive në matje dhe lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit.




Figura 16. Uji pa të ardhura për grupin 1 në vitin 2014

Humbjet e dukshme zënë një përqindje të madhe të humbjeve edhe për Sh.a. UK Tiranë (71%) ose 44,500 mijë m³, Sh.a. UK Elbasan (50%) ose 5,515 mijë m³, dhe Sh.a. UK Shkodër Qytet (90%) ose 7,127 mijë m³, situatë kjo e rënduar nga lidhjet e shumta të paligjshme në transmetim dhe në shpërndarje si dhe mungesa e aparateve ujëmatës. Puna për reduktimin i tyre, me një administrim sa më të mirë të shoqërisë, do të bënte të mundur uljen e treguesit për ujin pa të ardhura.




Figura 17. Tendenca e Humbjeve te dukshme dhe reale për grupin 1 në vitin 2014

Grupi i dytë i shoqërive

Në grupin e dytë të përbërë nga 21 shoqëri, 12 prej tyre kanë nivelin e ujit pa të ardhura nën 50%. Për performancë më të mirë dallohen Sh.a. UK Kukës me 20.14%, Sh.a. UK Librazhd me 23.07%, Sh.a. U Bilisht me 24,13% dhe Sh.a. U Korçë Fshat me 30,59%. Operatorin Sh.a. UK Himarë me vlerën 10,9 % të humbjeve nuk e kemi marrë në konsideratë për të dhëna të pabesueshme.

Për përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi, në krahasim me vitin 2013, vlen të përgëzohen operatori Sh.a. U Bilisht i cili si pasojë e ndërtimit të ujës-jellës të ri, rritjes së nivelit të matjes për ujin e prodhuar në 100% si dhe reduktimin e lidhjeve të paligjshme në rrjet shpërndarës ka ulur humbjet në vlerën (37,44%), Sh.a. U Shkodër fshat me 21,72% si dhe Sh.a. UK Burrel me 10,02% si pasojë e rritjes së sasisë së ujit të faturuar si dhe reduktimin e humbjeve të paligjshme në transmetim dhe në shpërndarje.




Figura 18. Uji pa të ardhura për grupin 2 në vitin 2014

Kanë performuar keq për këtë vit, duke pësuar rritje të ujit pa të ardhura, Sh.a. UK Lushnjë fshat, Sh.a. UK Përmet, Sh.a. U Rrogozhinë, Sh.a. UK Patos, Sh.a. UK Pogradec, Sh.a. UK Tepelenë, Sh.a. UK Mallakastër.

Të dhënat për tre vitet e fundit tregojnë përkeqësim në vlera të mëdha të ujit pa të ardhura për Sh.a. Tepelenë me 10,09%, Sh.a. U Patos me 17,91% dhe Sh.a. UK Ballsh (Mallakastër) me 11,25% si pasojë e sasisë së madhe të ujit që humbet nga sistemi shumë i amortizuar si dhe mungesa e matësve në prodhim dhe në shpërndarje, Sh.a. UK Pogradec megjithëse ka një sistem me gjendje të mirë teknike, ka rënie 23,56% të ujit pa të ardhura si pasojë e

rënies së ujit të faturuar, lidhjet e paligjshme, mos pajisja me matësa në zonat informale dhe reagimi jo në kohën e duhur për eliminimin e defekteve.




Figura 19. Tendanca e Humbjeve të dukshme dhe reale për grupin 2 në vitin 2014

Pavarësisht problematikave që këto shoqëri të grupit të dytë hasin në plotësimin e Bilancit të ujit e sidomos në ndarjen e komponentëve të tij (p.sh Librazhdi raporton 0% humbje të dukshme apo Rrogozhina 3% humbje reale duke pasur një rrjet të amortizuar), trendi i humbjeve të dukshme është i qartë dhe nga grafiku. Humbjet e dukshme janë të theksuara për Sh.a. UK Tepelene (44% ose 203 mijë m³), për Sh.a. UK Gjirokastër Qytet (84% ose 3,289 mijë m³), për Sh.a. UK Peshkopi (60,38% ose 632 mijë m³), të gjitha këto si pasojë e lidhjeve të shumta të paligjshme dhe mungesa e aparateve ujëmatës në shpërndarje dhe në prodhim.

Grupi i tretë i shoqërive

Shoqëritë e këtij grupi, sikurse shihet dhe në grafik, nuk paraqesin qëndrueshmëri në performancën e tyre gjatë 3 viteve të fundit. Nga 25 shoqëri, 13 prej tyre janë në nivelin mbi 50% të ujit pa të ardhura kjo si rezultat jo vetëm i një menaxhimi jo të mirë por dhe sepse sistemet e ndërtuara në të shumtat e rasteve janë shumë të vjetër.

Për performancë të mirë dallohen Sh.a. UK Krastë me (27,71%) si rezultat i reduktimit të humbjeve në S/Pompave dhe në rrjetin shpërndarës, Sh.a. UK Rubik me (20,81%), Sh.a. U Gjirokastër Fshat me (23,11%).

Nga krahasimi me të dhënat e vitit 2013, përkeqësim të këtij treguesi, kanë pësuar Sh.a. UK Divjakë me rritje (24,26%) si pasojë e lidhjeve të paligjshme, mungesa e matësive në prodhim dhe në shpërndarje, Sh.a. U Bulqizë me (18,45%) si pasojë e lidhjeve të paligjshme dhe humbjet e shumta në rrjet shpërndarës, Sh.a. U Has me (6,42%) si dhe Sh.a. U Selenicë me (9%).

Kanë patur përmirësim të treguesit Sh.a. UK Krastë me (9,34 %) si pasojë e eliminimit të lidhjeve të paligjshme dhe të reagimit në kohë për riparime të rrjedhjeve në rrjet shpërndarës, Sh.a. U Delvinë me (3,36%), Sh.a. UK Ersekë me (6,14%), Sh.a. UK Fushë Krujë me (14,21%), Sh.a. U Ura Vajguore me (11,78%) e cila ka reduktuar lidhjet e paligjshme në shpërndarje si dhe rrjedhjet në S/P dhe depot e ujit.




Figura 20. Uji pa të ardhura për grupin 3 në vitin 2014

Në bilancet e ujit të dërguara për vitin 2014 ashtu si dhe në 2013, shoqëritë e grupit të tretë janë më problematike në plotësimin e saktë të tij si dhe kanë pasaktësi në raportim, prandaj dhe për këto shoqëri nuk është kryer një analizë e detajuar e humbjeve të dukshme. Në përgjithësi për 12 shoqëri humbjet e dukshme zënë rreth 50% të humbjeve totale.

Përfundime

Edhe gjatë vitit 2014, nuk kemi përmirësime të ndjeshme të ujit pa të ardhura, niveli prej 67.2% i humbjeve në prodhim, transmetim, shpërndarje dhe faturim është rezultat i sistemeve të amortizuara të furnizimit me ujë dhe një administrimi jo të mirë të shoqërive UK.

Nga analiza e bërë, rezulton se gjendja në sektor është shumë shqetësuese, numri i shoqërive që kanë performancë të mirë ka rënë në 7, performojnë dobët 18 shoqëri dhe 30 prej tyre vazhdojnë të performojnë keq.

Analiza e Bilancit të Ujit tregoi se volumi i ujit që humbet nga administrimi jo i mirë në raport me sasinë vjetore të prodhuar nga shoqëritë është rreth 37% ndërsa ato reale janë 30%.

Nisur nga kjo, shoqëritë UK për të ulur treguesin e ujit pa të ardhura, duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të reduktuar uljet administrative, duke bërë evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme, duke pajisur të gjithë kategoritë e klientëve me ujëmatës dhe

njëkohësisht të shoqëruara këto me rikonstrukcione dhe ndërtime të reja segmentesh në rrjetin e furnizimit me ujë si dhe uljen konsumit të energjisë së harxhuar për ujin e prodhuar. Format i "Bilancit të ujit" është një dokument që ERRU i kërkon të gjitha shoqërive, në mënyrë që të kontrollojnë dhe vlerësojnë volumet e ujit që nuk sjellin të ardhura. Vlerësimi dhe plotësimi korrekt i bilancit të ujit është pasqyra ku shoqëritë shohin se nga duhet ta nisin punën për eliminimin e këtyre humbjeve.

Formatet e dorëzuar për këtë vit kanë treguar që ende shumë shoqëri nuk dinë të bëjnë vlerësimin e humbjeve sipas zërave ose e neglizhojnë atë. Pasqyrimi me saktësi dhe vërtetësi i realitetit ndihmon së pari shoqëritë në vetëvlerësimin e situatës, por edhe palët e interesit për këtë sektor.

Reduktimin e ujit pa të ardhura, ERRU e ka parë gjithmonë si një nga treguesit kryesorë për të patur shoqëri të qëndrueshme financiarisht, mbështetja e rregullatorit nëpërmjet instrumenteve që ai përdor do të jetë e vazhdueshme për të gjitha ato shoqëri që përpiqen që gjendja në sektor të ndryshojë dhe të arrijnë objektivat strategjike të vendosur për këtë qëllim.

3.1.6 Niveli i matjes

Niveli i Matjes është raporti i lidhjeve me matës kundrejt numrit total të lidhjeve. Ky tregues nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë, pasi analizon vetëm lidhjet me matësa të kategorive të konsumatoreve. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "uji pa të ardhura".

Duke marrë në konsideratë 3 vitet e fundit, ky tregues ka qenë pozitiv nga viti në vit, por krahasuar me vitin 2013 nuk ka pësuar rritje të konsiderueshme. Për vitin 2012 ky tregues ka qenë 55.1%, për vitin 2013 ka qenë 59% dhe për vitin 2014 ky tregues ka shkuar në 61.2%.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, objektivi i këtij treguesi për vitin 2014 është 65%, çka do të thotë që jemi akoma larg këtij treguesi, sidomos dhe nëse marrim parasysh rritjen progresive të viteve të mëparshme. Për vitin 2012 rritja ka qenë 4.5%, për vitin 2013 rritja ka qenë 3.9% dhe për vitin 2014 kjo përqindje është rritur vetëm me 2.2 % rritje, krahasuar me vitin 2013.

Niveli i matjes është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë. ERRU ka vënë objektiv për të gjitha shoqëritë vlerën 85%, por sipas ecurisë ndër vite, mbetet ende shumë punë për tu bërë në këtë drejtim deri në arritjen e këtij treguesi.

Grupi i parë i shoqërive

Ky është grupi i operatorëve të mëdhenj. Për të pestin vit radhazi SHA UK Korçë vazhdon të jetë shoqëria e vetme me treguesin 100% në shërbimin e furnizimit me ujë të matur. Të gjitha shoqëritë e tjera kanë nivelin e matjes nën kufirin e performancës së mire prej 85 %. Nivelin më të ulët të matjes për këtë grup e ka shoqëria UK Vlorë me 26.92 % megjithëse ka pasur rritje nga viti në vit.

Për vitin 2014, në total, ky grup nuk ka ndryshime në performancë, pasi janë po të njëjtat të 7 shoqëritë që kanë pësuar rritje, 1 shoqëri që ka rënie të lehtë me 0.36% e 2 shoqëri që kanë pësuar rënie të theksuar të këtij treguesi.

Rënie drastike për nivelin e matjes për këtë vit ka shënuar shoqëria UK Kavajë me 47.9 % duke u klasifikuar tek operatorët me nivelin më të ulët të matjes për këtë grup. Krahasuar me vitin 2013 përsëri shoqëria UK Berat - Kuçovë ka pësuar rënie me 5.34 %, ndërsa krahasuar me 2012 kjo rënie shkon në 10.01%.




Figura21. Niveli i matjes për grupin 1 në vitin 2014

Rritjen më të madhe të këtij treguesi me 20.95% e ka Sh.a. UK Shkodër qytet, duke e çuar këtë tregues në 37.14 % por përsëri mbetet ndër shoqëritë me treguesin më të ulët në këtë grup.

Shoqëritë që kanë pasur ecuri të mirë për këtë vit janë Sh.a. U Elbasan Fshat me një rritje 8.41 % duke e çuar vlerën e nivelit të matjes në 58.6 % si dhe Sh.a. UK Durrës me një rritje 9.92 % krahasuar me 2013 duke e çuar këtë vlerë në 80.03 %.

Grupi i dytë i shoqërive

Në këtë grup shihen rritje të dukshme të këtij treguesi, ku nga 3 shoqëri që kanë tejkaluar kufirin e performancës së mirë prej 85% për vitin 2013, në vitin 2014 janë 5 shoqëri që e kanë kaluar këtë kufi. Sh.a. U Lushnjë Fshat (100%), Sh.a. U Bilisht (96.57%) me rritjen me te larte nga 2013 me 17.66 %, Sh.a. UK Pogradec (93.95%), Sh.a. UK Librazhd (93.91%) dhe Sh.a. UK Kruje (86.26 %).

Në vitin 2011, Sh.a. U Lushnjë Fshat e transferoi shitjen e mëtejshme të ujit, komunave në zonën e saj të mbulimit. Në këtë mënyrë kjo shoqëri ka matur vetëm pjesën që ju shet komunave dhe jo konsumatorëve finalë. Është kjo arsyeja se përse kjo shoqëri ka tregues 100 % të nivelit të matjes.

Sh.a. U Kurbin, Sh.a. UK Gjirokastrë dhe Sh.a. U Patos vazhdojnë të kenë performancë shumë të dobët lidhur me shërbimin e matur, ku Patosi dhe Gjirokastra e kanë këtë tregues më pak se 1%, ndërsa Kurbinin ka pasur një rritje prej 3.01% duke e çuar këtë tregues në 3.91% por që mbetet përsëri në nivel shumë të ulët të këtij treguesi.




Figura 22. Niveli i matjes për grupin 2 në vitin 2014

Progres në lidhje me këtë tregues duke e rritur nivelin e matjes ka pasur vetëm Sh.a. UK Bilisht, ndërsa shoqëritë e tjera kane pasur luhatje të vogla të këtij treguesi.

Rënie të dukshme të këtij treguesi për këtë vit kanë raportuar 3 shoqëri, Sh.a. UK Burrel (-16.88%) duke e çuar këtë tregues në 49.93 %, Sh.a. UK Peshkopi (-9.86%) duke e çuar këtë tregues në 25.85% dhe Sh.a. U Shkodër Fshat (-12.25%) duke e çuar këtë tregues në 23.1%.

Grupi i tretë i shoqërive

Për të disatin vit radhazi, ky grup mbetet me shërbimin e matur në nivelet më të ulta. Këtë vit janë shtuar dhe raportimet për uljen e nivelit të matjes nga 1 shoqëri për vitin 2013 në 3 shoqëri për vitin 2014, Bashkia Pukë (-3.74%) duke çuar treguesin në 45.43 %, Sh.a. U Delvine (-7.75%) duke çuar treguesin në 40.62 % dhe Sh.a. UK Mirdite (-3.30%) duke çuar treguesin në 34.4 %.

Vetëm Divjaka vazhdon të raportojë 100% shërbimin e matur dhe është e vetmja shoqëri që kalon nivelin e performancës së mirë. Nga 25 shoqëri që ka ky grup, 13 prej tyre raportojnë më pak se 50% të lidhjeve të tyre me matësa, 6 shoqëri kanë raportuar 0% nivelin e matjes, ndërsa 1 shoqëri (Sh.a. U Bradashesh) nuk ka raportuar të dhëna.




Figura 23. Niveli i matjes për grupin 3 në vitin 2014

Rritje të nivelit të matjes në % të dukshme kanë raportuar 5 shoqëri ku 2 prej tyre vlen për tu përmendur pasi dhe rritja ka qenë shumë e dukshme përkatësisht: Sh.a. UK Peqin (+19.49%) krahasuar me 2012 (+30.40%) dhe Sh.a. U Has (+14.07%) krahasuar me 2012 (+50.15%). Sh.a. U Ura Vajgurore ka pasur një rritje prej (+8.94%), Sh.a. UK Ersekë (+6.35%) dhe Sh.a. UK Rubik (+ 5.97%)

Përfundime

Duke analizuar këtë tregues, për të tre grupet marre se bashku, shihet që për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 rritje të treguesit kanë raportuar 17 shoqëri, ndërsa për vitin 2014 rritje të konsiderueshme kanë raportuar vetëm 13 shoqëri, ndërsa shoqëritë e tjera mund të kenë pasur rritje, por të pa përfillshme.

Shoqëritë që kanë pësuar ulje të këtij treguesi janë rritur, krahasuar me 2013 ku kanë qenë 3 shoqëri me ulje të dukshme, ndërsa për vitin 2014 ky numër ka vajtur në 8. Përveç uljes në numër, këto shoqëri kanë pasur ulje drastike të treguesit të nivelit të matjes. Kjo tregon që shoqëritë duhet të bëjnë shumë më tepër punë nga ana e tyre pasi janë ende shumë larg për të arritur objektivat e vendosura nga strategjia.

Nga 57 shoqëri, vetëm 8 prej tyre raportojnë që operojnë mbi nivelin e performancës së mire përsa i përket shërbimit të matur përkatësisht 2 në grupin e parë, 5 në grupin e dytë dhe vetëm 1 për grupin e tretë. Në grupin e dytë dhe të tretë (por kryesisht në të tretin) ka shoqëri që pothuajse nuk e masin fare këtë shërbim me më pak se 1%, kryesisht këto janë shoqëritë e vogla.

Grupi i parë ka një nivel mesatar të matjes së ujit 59.2%, grupi i dytë ka një nivel mesatar të matjes së ujit 51.4% ndërsa grupi i tretë ka një nivel mesatar të matjes prej 25.02 duke pësuar një rritje të papërfillshme nga viti 2013 me 0.09 % dhe ku mesatarja e këtij grupi ka qenë 24.93%, sa gjysma e dy grupeve të para. Mesatarja e të tre grupeve për nivelin e matjes së ujit për vitin 2014 është 61.2 % me një rritje prej 2.2 % krahasuar me vitin 2013, por pa arritur të realizohet objektivi i këtij treguesi për vitin 2014 i cili ishte 65%, bazuar ne Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësve duke zhvilluar dhe inspektime ne shoqëritë, për të reduktuar nivelet e larta të shërbimit të pa matur. Operatorët kanë patur detyrim (bazuar në dy vendime të Këshillit të Ministrave) që deri në fund të vitit 2010 të kishin përfunduar instalimet e matësve për të gjithë klientët jo familjarë dhe objektivi për të ardhmen është që të pajisen me matës dhe klientë familjare, por ende janë shume larg realizimit të objektivit.

3.1.7 Kohëzgjatja e furnizimit me ujë

Dy nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit mbeten kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e tij. Ndryshimet e këtyre treguesve janë të lidhur drejtpërdrejt me konsumatorin. Me arritjen e standardeve të kërkuara për këta dy tregues, shoqëritë përmirësojnë shërbimin ndaj konsumatoreve, rrisin të ardhurat e shoqërisë dhe ulin kërkesën e konsumatoreve për burime të tjera të furnizimit me ujë.

Për vlerësimin e këtij treguesi është përdorur mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë, tregues i cili për vitin 2014 është 12.1 orë/ditë, me një rritje nga viti 2013 ku mesatarja ishte 11.8 orë/ditë. Pavarësisht kësaj, akoma kërkohet shumë punë nga shoqëritë për të arritur objektivin e performancës së mirë të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, objektivi i cili për vitin 2014 është 15 ore, dhe aq më tepër objektivin e vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë.

Grupi i parë i shoqërive

Grupi i parë i shoqërive për vitin 2014 mesatarisht ofron 13.69 orë ujë në ditë, ndërsa për vitin 2013 ky tregues ka qenë 13.66 orë ujë në ditë duke mos shënuar ndonjë përmirësim të dukshëm.

Sh.a. UK Korçë vazhdon të mbetet e vetmja shoqëri që ofron 24-orë furnizim me ujë. Sh.a. UK Shkodër e Sh.a. UK Fier, të cilat ofrojnë përkatësisht 21.54 dhe 20.28 orë në ditë, vazhdojnë të qëndrojnë mbi nivelin e performancës së mirë, por pothuajse në të njëjtat vlera me vitin 2013.




Figura 24. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 1 në vitin 2014

Rritje të kënaqshme për këtë tregues në këtë grup ka pasur shoqëria U Elbasan Fshat me një rritje prej 1.72 ore duke çuar orët e furnizimit me ujë në 17.75 orë/ditë, shumë afër

performancës së mirë. Duke e krahasuar me vitin 2012 rritja për këtë shoqëri ka qenë me 3.11 orë. Shoqëritë e tjera kanë ndryshime pothuajse të papërfillshme, krahasuar me vitin 2013.

Edhe për vitin 2014, shoqëritë që ofrojnë furnizim me ujë nën kufirin e performancës së dobët, me më pak se 8.0 orë/dite janë respektivisht Sh.a. UK Durrës që furnizon me 7.52 orë në ditë dhe Sh.a. UK Sarandë që furnizon me 4.55 orë në ditë.

Shoqëria që ka pasur rënie në orët e furnizimit me ujë është Sh.a. UK Berat-Kuçovë, e cila për të tretin vit radhazi pëson vetëm rënie në këtë tregues. Në vitin 2012 treguesi ka qenë 11.27 orë, në vitin 2013 ka qenë 10.63 orë dhe për vitin 2014 ka rënë në 9.53 orë. Kjo rënie ka qenë 1.1 orë krahasuar me vitin 2013 dhe 1.74 orë krahasuar me vitin 2012.

Grupi i dytë i shoqërive

Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë për vitin 2014 në grupin e dytë është 11.33 orë. Krahasuar me vitin 2013, ky tregues ka një rënie me 0.52 orë. 12 shoqëri të këtij grupi kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel me vitin 2013, përse i përket orareve të furnizimit me ujë duke mos pasur ndryshime të ndjeshme.




Figura 25. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 2 në vitin 2014

Krahasuar me vitin 2013, është rritur numri i shoqërive që kanë arritur nivelin e performancës së mirë për sa i përket furnizimit të vazhdueshëm. Përmirësime në këtë tregues kanë pasur shoqëritë Sh.a. UK Librazhd, Sh.a. UK Pogradec, Sh.a. UK Lezhë dhe Sh.a. U Gramsh si dhe Sh.a. U Bilisht me një rritje prej 16.66 orë, duke çuar këtë tregues në 24 orë shërbim të furnizimit me ujë.

Për këtë grup shkon në 2 numri i performuesve më të mirë me 24 orë në ditë shërbim të ofruar, shoqërisë Sh.a. UK Librazhd i shtohet dhe shoqëria Sh.a. U Bilisht, e cila ka përfunduar

projektin për rikonstrukcionin e rrjetit të ujësjellësit të qytetit, duke bërë të mundur 24 orë/ditë furnizim me ujë për konsumatorët.

Numri i shoqërive që kanë performuar keq për këtë vit, me rënie të konsiderueshme, është i njëjte me vitin 2013, por janë operatorë të ndryshëm ata që nuk performojnë mirë. Sh.a. UK Burrel ka pësuar rënie me 4.31 orë, Sh.a. U Shkodër Fshat me 3.46 orë, Sh.a. UK Përmet me 5.61 orë duke shënuar dhe rënien më të madhe në këtë grup si dhe Sh.a. U Korçë fshat me rënie 2.54 orë.

Shoqëritë që kanë nivelin e këtij treguesi nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë) janë 6 e të njëjtat shoqëri me vitin 2013 (Sh.a. Lushnjë Fshat, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Lushnjë, Sh.a. U Kurbin, Sh.a. U Patos, dhe Sh.a. UK Gjirokastër) ndërsa Sh.a. U Himarë vazhdon të mos ketë raportime.

Sh.a. U Patos vazhdon të jetë shoqëria me performancën më të dobët në këtë grup me 3 orë furnizim me ujë në ditë. Krahasuar me vitin 2013, ka pasur një rritje vetëm me 0.11 ore, pothuajse e papërfillshme kjo dhe pa ndikim tek konsumatorët.

Grupi i tretë i shoqërive

Shoqëritë e grupit të tretë ofrojnë mesatarisht 10.33 orë ujë në ditë për vitin 2014, duke pësuar një rritje me furnizim 0.89 orë ujë në ditë, krahasuar me 2013.

Edhe për këtë vit Sh.a. UK Rubik vazhdon të jetë performuesi më i mirë i këtij grupi duke pasur dhe një rritje me 1 orë në furnizim dhe duke e çuar këtë tregues në 24 orë në ditë, sikurse më të mirët e grupeve të pare dhe të dytë. 6 shoqëri të këtij grupi kanë patur rritje të konsiderueshme të orëve të furnizimit, nga ku 3 kanë kaluar mbi nivelin e performancës së mirë prej 18 orë furnizim me ujë.

Sh.a. U Novoselë ka pësuar një rritje të konsiderueshme nga viti 2012 me 8.75 orë dhe duke ofruar 16.75 orë ujë në ditë për konsumatorët.

Ndërsa Sh.a. U Peqin dhe Sh.a. U Burrel kanë pasur rritje përkatësisht 2.74 dhe 1.29 orë/ditë më shumë duke bërë të mundur që të kalojnë dhe kufirin e performancës së dobët me 8 orë furnizimi me ujë.

Gjirokastër fshat vazhdon të ketë rënie me 2.1 orë/ditë krahasuar me vitin 2013 dhe 4.99 orë/ditë krahasuar me vitin 2012 duke e çuar këtë tregues në 8.01, pranë kufirit të performancës së dobët.

Rënie më të madhe për këtë grup ka raportuar Sh.a. UK Kraste me 3.49 orë/ditë me pak, duke e çuar këtë tregues në më të ulëtën e grupit me 1.32 orë/ditë furnizim me ujë dhe duke u klasifikuar përsëri në shoqërinë me performancë më të dobët për vitin 2014.

Pas tij rënie 1.85 orë/ditë nga viti 2013, ka raportuar Sh.a. U Orikum duke e ulur kohen e furnizimit me ujë në 3.59 orë/ditë. Sh.a. UK Fushe Arrëz ka pasur një rënie me 2.63 orë/ditë, por përsëri mbetet në vlerat e performancës së mirë pasi ofron furnizim me ujë 11.95 orë/ditë.




Figura 26. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin 3 në vitin 2014

Në total për këtë grup, mbi kufijtë e performancës së mirë janë 3 operatore (Sh.a. UK Rubik, Sh.a. UK Erseke dhe Bashkia Pukë) duke rritur numrin e shoqërive të mira.

Në kufijtë e performancës së pranueshme janë 13 shoqëri, me orare furnizimi midis 8 dhe 18 orë në ditë, por që përbëjnë një shoqëri më shumë se në vitin 2013 që ka kaluar në kufirin e performancës së pranueshme.

Nën kufirin e performancës së dobët, me më pak se 8 orë furnizim me ujë në ditë, janë 8 shoqëri, dy më pak krahasuar me vitin 2013 dhe Gjirokastër fshat që është në kufirin e kësaj performance.

Përfundime

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për vitin 2014 ka qenë mesatarisht me 12.1 orë ujë në ditë, duke pësuar një rritje nga 11.5 orë ujë në ditë që ka qenë për vitin 2013.

Ky tregues vazhdon të jetë nën nivelin e objektivit strategjik për vitin 2014, i cili është 15 orë në ditë, si dhe nën nivelin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë. Si rrjedhojë konsumatorët vazhdojnë ta zgjidhin me burime alternative problemin e furnizimit me ujë deri në përmbushjen e këtij treguesi.

Nga analiza e të tre grupeve vihet re se nga 2 shoqëri që për vitin 2012 ofronin 24 orë/ditë furnizim me ujë, për vitin 2014 tashme janë 4 shoqëri që e ofrojnë 24 ore këtë shërbim, një shoqëri nga grupi i parë, dy nga grupi i dytë dhe një nga grupi i tretë.

Krahasuar me vitin 2013 nga ku në total 36 shoqëri kanë qenë mbi nivelin e performancës së dobët prej 8 orë furnizim me ujë në ditë, për 2014 numri i tyre ka vajtur në 39 shoqëri mbi këtë kufi. Gjithashtu këtë vit janë raportuar ulje në orët furnizimit me më shumë se 1 orë nga 10 shoqëri, ndërsa pjesa tjetër e shoqërive kanë pasur ulje nën 1 orë furnizim me ujë.

Arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet, por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm, dhe kjo tregohet dhe nga eksperiencat e shoqërive me performancë të mirë.

Për ERRU vazhdon të mbetet një nga prioritet kryesore, përmirësimi i shërbimit për konsumatorët. Kjo tregohet dhe nga rëndësia që i është dhënë këtyre treguesve, në vlerësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, si dhe gjatë aplikimit për ndryshimin e tarifave. ERRU ka vendosur objektiva mbi performancën e operatorëve për këta tregues dhe më pas monitoron ecurinë e tyre sipas objektivave të vendosur.

ERRU do t'ju kërkojë operatorëve të përfshijnë këto objektiva në planet e tyre të biznesit për të gjetur rrugët dhe mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

3.1.8 Mbulimi me kanalizime

Treguesi i mbulimit me kanalizime është i lidhur me ofrimin e këtij shërbimi nga shoqëritë Ujësjetellës Kanalizime, ai vjen si raporti i popullsisë së shërbyer me largimin e ujërave të ndotura me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të një operatori. Në sektorin ujësjetellës kanalizime në Shqipëri jo të gjitha shoqëritë i ofrojnë të dyja këto shërbime, furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura. Nga 57 shoqëri vetëm 32 prej tyre ofrojnë këtë shërbim dhe vetëm këto janë marrë në konsideratë në analizën e mëposhtme dhe në grafikët e paraqitur.

Për këtë tregues ERRU ka vendosur që kufiri për një performancë të mirë të jetë 75%. Mesatarja e këtij treguesi në rang vendi që vazhdon të jetë 51%, tregon që ky shërbim është larg objektivave strategjike të vendosur.

Grupi i parë i shoqërive

Nga 11 shoqëritë e këtij grupi vetëm 9 shoqëri e ofrojnë shërbimin e kanalizimeve. Edhe për këtë vit shoqëria Elber sh.p.k (sot Elbasan Qytet Sha) vazhdon ta ruajë mbulimin me kanalizime në vlerën (100 %).




Figura 27. Mbulimi me Kanalizime për grupin 1 në vitin 2014

Gjatë këtij viti krahasuar me vitin 2013 ka pasur shoqëri që e kanë rritur vlerën e këtij treguesi si: Sh.a. UK Korçë me (6,91%), Sh.a. UK Shkodër me (3,6 %).

Shoqëritë Sh.a. UK Durrës, Sh.a. UK Saranda dhe Sh.a. UK Berat-Kuçovë këtë vit e kanë ruajtur të njëjtën shkallë mbulimi si vitin paraardhës.

Me performancë më të dobët edhe për këtë vit paraqitet shoqëria Sh.a. UK Kavajë (24.78%) e cila nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta rritur vlerën e këtij treguesi.

Grupi i dytë i shoqërive

Nga 21 shoqëri të grupit të dytë, 13 shoqëri ofrojnë shërbimin me kanalizime dhe vetëm 3 prej tyre Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. UK Librazhd qëndrojnë mbi kufirin e performancës së mirë prej 75%. Në këtë grup mund të përmendim edhe Sh.a. UK Burrel e cila ka një rritje për vitin 2014 të vlerës së këtij treguesi me 3.91%. Shoqëria me performancë më të mirë për grupin e dytë, për këtë tregues është Sh.a. UK Krujë me 93.79%.

Me performancë më të dobët vazhdojnë të mbeten Sh.a. UK Gjirokastrë Qytet (38.77%), Sh.a. UK Mallakastër (27.74%) dhe më keq akoma Sh.a. UK Rrogozhinë (16.1%). Shoqëria Sh.a. UK Tepelenë edhe pse është viti i dytë që raporton për këtë shërbim nuk ka bërë asnjë përpjekje për të rritur vlerën e këtij treguesi kjo vlerë vazhdon të jetë (54.58%), si në vitin 2013.




Figura 28. Mbulimi me Kanalizime për grupin 2 në vitin 2014

Gjithashtu, tendence negative ka pasur dhe Sh.a. UK Pogradec që ka patur rënie të vogël të vlerës së këtij treguesi me (1.32%). Vlen për tu theksuar se asnjëra nga shoqëritë nuk po bën përpjekje të dukshme për të rritur shkallën e mbulimit me kanalizime prandaj dhe situata në sektor vazhdon të mos ketë ndryshime.

Grupi i tretë i shoqërive

Shërbimin me kanalizime në grupin e tretë e kryejnë vetëm 11 shoqëri nga 25 shoqëritë e këtij grupi. Shoqëria sha UK Ersekë vazhdon ta ruaj mbulimin me kanalizime në vlerën (100 %), duke u renditur edhe për këtë vit e para në këtë grup.

Nga grafiku vihet re se gjatë këtij viti Sh.a. UK Delvinë ka pësuar një rënie prej (24.44 %), e cila ka ndodhur pasi zona e mbulimit është e njëjtë por në raportimin e vitit 2013 kjo shoqëri ka përfshirë në sistem edhe klientë të cilëve nuk i ofrohej shërbimi me kanalizime siç ishin banorët e zonave kodrinore (të cilët operojnë me gropa septike).




Figura 29. Mbulimi me Kanalizime për grupin 3 në vitin 2013

Në grafikun e mësipërm vihet re se gjatë vitit 2014 vetëm Sh.a. UK Krastë ka pësuar rritje të vlerës së këtij treguesi me (4.64%).

Me performancën më të dobët vazhdojnë të jenë Sh.a. UK Pukë fshat (2.08%), Sh.a. UK Rubik (27.8%) me një rritje prej (1.29%). Sh.a. UK Fushë Arrëz (33.1%) dhe Fushë Krujë (34.1%) kanë të njëjtat vlera të treguesit për 3 vite radhazi, ndërsa Bashkia Pukë (39.43%) raporton një rritje të treguesit në vlera fare të papërfillshme. Në këtë grup Sh.a. UK Libohovë nuk është marrë në konsideratë në analizë për shkak se rezulton e dhënë jo e saktë.

Përfundime

Situata për mbulimin me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime edhe për këtë vit, vazhdon të jetë në të njëjtin nivel. Përqindja e mbulimit me shërbim të furnizimit me ujë në shkallë vendi vazhdon të jetë 81% e popullsisë në zonën e juridiksionit të shoqërive UK, ndërsa vetëm 51% e kësaj popullsie mbulohet me shërbimin me kanalizime. Siç vihet re mbulueshmëria me shërbimin me kanalizime është shumë më e ulët, kjo si rezultat i mos investimeve në këtë drejtim.

Edhe trajtimi i ujërave të ndotura mbetet një fushë prioritare në kontekstin e përpjekjeve për të pasur shërbime kanalizimi më të mira gjë që specifikohet në mënyrë të qartë në strategjinë kombëtare. Trajtimi i ujërave të ndotura ka përmirësuar cilësinë e shërbimit me kanalizime vetëm për 10 % të popullsisë në zonën e juridiksionit të operatorëve si rezultat i vënies në punë të 5 impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura që priten të pasohen edhe nga impiante të tjerë që janë në ndërtim e në projektim. Për momentin, vetëm pesë shoqëri kanë në funksionim impiant trajtimi të ujërave të ndotura, përkatësisht Sh.a. UK Kavajë, Sh.a. UK Pogradec, Sh.a. UK Korçë, Sh.a. UK Durrës dhe Sh.a. UK Shkodër të cilat janë dhe të licencuar nga ERRU për të ofruar këto shërbime.

Shifrat e analizës së mësipërme të performancës tregojnë nevojën për përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e shërbimit të kanalizimeve në pothuajse të gjithë Shqipërinë. Sikurse shihet nga analiza e bërë për të tre grupet, gjendja në sistemin e kanalizimeve vazhdon të jetë pothuaj e njëjtë për disa vite radhazi. Disa shoqëri gjatë këtij viti kanë bërë përpjekje për të rritur shkallën e mbulimit me kanalizime, por vlerat e rritura kanë qenë të papërfillshme për të ndryshuar gjendjen e mbulueshmërisë në vend.

Në shërbimin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ofruar nga shoqëritë UK kanë më shumë akses popullsia që jeton në zonat urbane (76% e mbulueshmërisë në furnizimin me ujë dhe 98% në shërbimin e kanalizimeve i përket zonës urbane), ndërsa ajo rurale ka akses kryesisht vetëm në furnizimin me ujë (24% e mbulueshmërisë në furnizimin me ujë dhe vetëm 2% në shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura i përket zonës rurale). Për pjesën tjetër të popullsisë, ky shërbim kryesisht administrohet nga sektorë brenda komunave/bashkive ose dhe vetadministrohet nga banoret. Nga rezultati i studimit të kryer nga ERRU për zonat jashtë juridiksionit të shoqërive UK, rezultoi se popullsia totale në këto zona është 546,046 banorë, ku vetëm 64% e tyre përfitojnë nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe 28% kanë akses në shërbimet e kanalizimeve, të ofruara nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore. Infrastruktura në këto zona mungon ndjeshëm, veçanërisht sa i takon shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.

Me miratimin e reformës së re territoriale do të lehtësohet çështja e rregullimit ligjor të zonave të pambuluara, pasi njësitë e vogla do të bëhen pjesë e bashkive më të mëdha. Një situatë më e qartë e zonave të reja territoriale, të cilat administrohen nga shoqëritë UK është paraqitur në hartën e mëposhtme.



Figura 30. Harta e njësive të reja administrative dhe zonave të cilat janë nën administrimin e shoqërive U&K.

3.1.9 Perceptimi Rregullator

Treguesi "Perceptimi rregullator" vlerëson shkallën me të cilën shoqëritë UK mbështesin ERRU në arritjen e objektivave të misionit rregullator. Në mënyrë që rregullatori të arrijë objektivat e misionit të tij rregullator në zbatim të Ligjit 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, i ndryshuar, është e nevojshme që operatorët të përmbushin detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe rregulloret në fuqi si dhe të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin rregullator. Për të bërë vlerësimin e këtij treguesi janë marrë në konsideratë katër aspekte kryesore:

- **Licencimi:** kur shoqëria operon me licencë të vlefshme nga ERRU; (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve në varësi të zhvillimit të procesit të licencimit, kur shoqëria ka aplikuar për tu paisur me licencë apo për rinovimin e saj në vitin 2014).
- **Tarifë e miratuar nga ERRU:** kur shoqëria operon me tarifë të miratuar nga ERRU, (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve në varësi të zbatimit të tarifave dhe zhvillimit të procesit të miratimit të tarifave nëse shoqëria ka aplikuar për miratimin e tyre në vitin 2014).
- **Pagesat rregullatore:** kur shoqëria ka kryer pagesat rregullatore kundrejt ERRU në kohë dhe në masë të plotë (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve nëse pagesat nuk janë kryer plotësisht);
- **Komunikimi me ERRU:** nëse shoqëria u është përgjigjur informacioneve, kërkesave apo njoftimeve të ndryshme bërë nga ERRU (maksimumi 25 pikë kur të gjitha përgjigjet janë dhënë në kohë dhe të plotë).

Vlerësimi i përgjithshëm maksimal është 100 pikë.

Tabela si me poshte liston pikët e dhëna 58 shoqërive për secilin nga këto aspekte, duke i renditur ato në grupet përkatëse sipas pikëve të përgjithshme të marra për këtë tregues.

Grupi 1		Licenca	Tarifa	P.rreg	Komunik.	Totali
UK	Elber sh.p k	25	25	25	15	90
UK	Korçë	25	25	25	15	90
UK	Berat - Kuçovë	25	25	15	20	85
UK	Shkodër	15	25	25	15	80
UK	Tiranë	25	25	10	15	75
UK	Durrës	25	25	10	15	75
UK	Sarandë	25	25	20	5	75
UK	Fier	25	25	3	20	73
U	Elbasan fshat	25	25	10	10	70
UK	Vlorë	0	25	20	15	60
UK	Kavajë	15	25	10	10	60

Grupi 2						
UK	Lezhë	25	25	25	25	100
UK	Lushnjë	25	25	20	25	95
UK	Gjirokastrë	15	25	25	20	85
UK	Gramsh	25	25	10	20	80
U	Peshkopi	25	25	10	20	80
U	Bilisht	25	25	25	5	80
UK	Tepelenë	25	25	10	15	75
UK	Pogradec	25	25	8	15	73
U	Kurbin	25	25	0	20	70
UK	Librazhd	25	25	5	15	70
UK	Krujë	25	25	5	15	70
U	Përmet	25	25	15	5	70
UK	Burrel	25	25	10	10	70
U	Lushnjë fshat	25	25	5	5	60
UK	Rrogozhine	25	25	0	10	60
UK	Kukës	15	15	0	25	55
U	Korçë fshat	25	15	–	15	55
U	Shkodër fshat	15	25	0	10	50
UK	Patos	25	–	–	15	40
UK	Himarë	25	15	–	0	40
U	Mallakastër	5	–	–	20	25
Grupi 3						
U	Bulqizë	25	25	25	20	95
UK	Rubik	25	25	16	20	86
U	Orikum	25	25	25	10	85
U	Ura Vajgurore	25	25	10	20	80
U	Poliçan	25	25	25	5	80
UK	Ersekë	25	25	13	15	78
UK	Bashkia Pukë	25	25	13	15	78
UK	Mirditë	15	25	20	15	75
UK	Delvinë	25	25	0	20	70
UK	Krastë	10	25	25	10	70
U	Gjirokastrë Fshat	0	25	0	20	45
U	Selenicë	25	25	0	15	65
UK	Fushë Krujë	25	15	–	20	60
U	Tropojë	25	25	0	10	60
U	Novoselë	10	25	4	5	44
U	Divjakë	25	–	–	15	40
UK	Peqin	0	25	0	15	40
U	Skrapar	10	25		5	40
UK	Libohovë	25	–	–	15	40
U	Vau i Dejës	25	–	–	10	35
U	Has	5	15	–	10	30
U	Puke fshat	0	–	–	15	15
UK	Këlcyrë	0	–	–	10	10
UK	Fushë Arrëz	5	–	–	0	5
U	Bradashesh					

Tabela 7. Perceptimi Rregullator: Pikët e performancës të arritura sipas grupeve

Licencimi

Liçenca është instrumenti kryesor që garanton konsumatorët se operatori ka aftësinë për të ofruar shërbim në përputhje me standardet e miratuara. Sipas legjislacionit në fuqi çdo operator që kryen shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të pajiset nga ERRU me licencën përkatëse.

ERRU në vazhdimësi ka monitoruar situatën e liçensimit në sektor dhe është përpjekur të sjellë në vëmendjen e shoqërive respektimin e kushteve të liçensimit, të cilat janë objekt i monitorimit të ERRU. Proçesi i liçencimit përfshin jo vetëm paisjen me liçencë të shoqëritë paliçensuara por edhe rinovimin e liçencës, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë. Në varësi të përpjekjeve që shoqëritë kanë bërë në vitin 2014 për tu pajisur me liçencë apo për rinovimin e saj në kohë si dhe plotësimit të dokumentacionit të aplikimit shoqëritë janë vlerësuar me një pjesë të pikëve.

Shoqëritë të cilat nuk kanë marrë asnjë pikë janë Sh.a U Këlcyrë dhe Sh.a UK Pukë Fshat të cilat vazhdojnë të operojnë pa liçencë si dhe Sh.a. UK Vlorë, Sh.a.UK Peqin dhe Ndërmarrja Gjirokastër fshat të cilat kanë paraqitur probleme në respektimin e kushteve të kerkuara për rinovimin e liçencës.

Shoqëritë si Sh.a UK Mallakastër, Sh.a U Has, Sh.a UK Fushë Arrëz janë vlerësuar me një minimum pikësh (5 pikë), pasi kanë bërë përpjekje për të filluar proçedurën e liçencimit, por dokumentacioni i aplikimit nuk përmbushte kërkesat ligjore të liçensimit prandaj edhe procesi nuk ka vazhduar.

Gjatë vitin 2014 Sh.a U Krastë, Sh.a U Novoselë dhe Sh.a.UK Skrapar kanë paraqitur kërkesën për rinovimin e liçencës, por procesi i liçencimit nuk ka përfunduar pasi dokumentacioni nuk ishte i plotë. Këto shoqëri janë vlerësuar me 10 pikë.

Për Sh.a UK Gjirokastër, Sh a UK Shkodër Fshat dhe Sh.a UK Mirditë procesi i liçencimit përfundoi në fillim të vitit 2015 prandaj edhe janë vlerësuar me 15 pikë.

Në të ardhmen vlerësimi do të përfshijë gjithashtu edhe zbatimin e kushteve të liçencës nga të liçencuarit, të cilat do të jenë objekt i monitorimit të ERRU.

Tarifat e miratuara nga ERRU

Në vitin 2014, faturimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve kryhet sipas tarifave të miratuara nga ERRU për 46 shoqëri. Këto shoqëri janë vlerësuar me 25 pikë.

Shoqëritë të cilat zbatojnë tarifa të miratuara nga ERRU, por nuk kanë aplikuar për rinovimin e tyre megjithëse afati i përdorimit të tyre ka përfunduar si Sh.a UK Kukës dhe Sh.a UK Fushë Krujë, Sha U Has janë vlerësuar me një pjesë të pikëve (15 pikë). Edhe shoqëritë Sh.a U Korçë Fshat dhe Sh.a UK Himarëtë cilat gjatë këtij viti kanë aplikuar për miratimin e tarifave pranë ERRU janë vlerësuar me 15 pikë.

Sh.a U Patos, Sh.a UK Mallakastër, Sh.a U Divjakë, Sh.a U Vau i Dejës, Sh.a UK Libohovë, Sh.a UK Fushë Arrëz, Sh.a U Këlcyrë, dhe Sh.a UK Pukë Fshat operojnë me tarifa të pamiratuara nga ERRU. Enti Rregullator do të vazhdojë të nxisë këto shoqëri për të paraqitur aplikimet për

miratimin e tarifave. Në zbatim të Metodologjisë " Për Vendosjen e Tarifave", miratimi i tarifave për shoqëritë që aplikojnë për herë të parë bëhet me procedurë të përshpejtuar.

Pagesat rregullatore

Në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 pagesat e rregullimit të operatorëve janë burim financimi për shpenzimet vjetore të ERRU, të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Pagesat e rregullimit janë detyrime të operatorëve ndaj Entit, të përcaktuara prej tij, të pranuar e të nënshkruara prej palëve, në kontratën për aplikimin e tarifave të shërbimit. Konstatojmë se në drejtim të shlyerjes së këtyre detyrimeve ligjore e kontraktuale, në vitin 2014 është rritur ndjeshëm niveli i arkëtimit krahasuar me dy vitet e mëparëshme.

Pagesa rregullatore vjetore për vitin 2014 rezulton në shumën 44 507 mijë lekë, ndërsa arkëtimi është në shumën 50 127 mijë lekë, shifër kjo ndër më të lartat e realizuara ndër vite. Në vështrim të parë të shifrave të krijuar përshtypja sikur janë arkëtuar totalisht detyrimet vjetore, por duke i analizuar me thellë ato rezulton se për llogari të vitit janë arkëtuar vetëm 20 përqind.

Shoqëritë që kanë likuiduar në kohë pagesat rregullatore janë vlerësuar me pikët maksimale. Këto shoqëri janë Sha UK Korçë qytet, Sha UK Lezhë, Sha UK Shkoder, Sh.a U Bilisht, Sh.a U Bulqizë, Elber Shpk (sot Elbasan Qytet Sha), Sh.a UK Gjirokastrë Qytet, Sha U Kraste, Sha U Orikum, Sha U Poliçan. Këto shoqëri janë vlerësuar me pikët maksimale. Gjithashtu gjatë këtij viti evidentohen shoqëri të cilat nuk kanë shlyer asnjë detyrim për llogari të vitit, të tilla janë: Sh.a U Delvinë, Sh.a U Gjirokastrë Fshat, Sh.a U Kukes, Sh.a U Kurbin, Sh.a UK Rogozhine, Sh.a U Selenicë, Sh.a U Shkoder Fshat, Sh.a U Skrapar. Shoqëritë e tjera janë vlerësuar me një pjesë të pikëve në varësi të masës së likuiduar të detyrimit.

Komunikimi me ERRU

Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi për tju përgjigjur kërkesave të ERRU është baza mbi të cilën është bërë vlerësimi përse i përket komunikimit me ERRU. Edhe gjatë vitit 2014 ERRU ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha shoqëritë nëpërmjet kërkesave për informacion si dhe takimeve e konsultimeve për diskutimin e çështjeve të ndryshme. Për ERRU bashkëpunimi dhe konsultimi në zhvillimin e mëtejshëm të instrumentave rregullatore, ka bërë të mundur që shoqëritë të ndërgjegjësohen dhe të vlerësojnë rolin e tij në rregullimin e sektorit. Siç tregojnë edhe pikët e rezultateve, pjesa më e madhe e shoqërive kanë qënë pjesëmarrës aktive në këtë proces.

Shoqëritë që janë vlerësuar me pikë maksimale janë Sh.a UK Lezhë, Sh.a UK Lushnje, Sh.a UK Kukës ndërsa 12 shoqëri të tjera, Sh.a UK Fier, Sh.a UK Gjirokastrë, Sh.a U Gramsh, Sh.a U Peshkopi, Sh.a U Kurbin, Sh.a UK Mallakastër, Sh.a UK Rubik, Sh.a U Bulqizë, Sh.a U Ura

Vajgurore, Sh.a U Delvinë, Sh.a UK Fushë Krujë, Sh.a U Gjirokastrë Fshat janë vlerësuar me 20 nga 25 pikë të munëshme.

Shoqëritë Sha U Fushë Arrëz, SHA UK Himarë kanë treguar interesin më të dobët ndaj kërkesave të Rregullatorit, prandaj edhe vlerësimi është zero pikë.

Përfundime

Vlerësimi i këtij treguesi për vitin 2014 tregon se shoqëritë ujësjellës kanalizime gjithmonë e më shumë po funksionojnë brenda kuadrit rregullator. Rezultatet e analizës së më sipërme tregojnë se megjithë përmirësimet e bëra ka vend për disa rregullime në lidhje me liçensimin dhe aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU si dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për likuidimin e pagesave rregullatore.

Por edhe komunikimin me ERRU ndonëse vlerësohet pozitivisht, nuk ka patur të njëjtin vlerësim nga të gjitha shoqëritë. ERRU vlerëson korrektësinë dhe përpjekjet e të gjitha shoqërive për të patur patur një bashkëpunim sa më të mirë. Shoqëritë UK duhet të ndërgjegjësohen më shumë në lidhje me përgjegjësitë që ato kanë për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga si për tju përgjigjur në kohë dhe me cillësi kërkesave të ERRU. Disa shoqëri, kryesisht të vogla, që nuk kanë vlerësim të mirë të treguesit të perceptimit rregullator pasi për arsye objektive nuk plotësojnë kërkesat formale të licencimit dhe miratimit të tarifave përmirësimi i performacën së këtij treguesi mund të vijë duke rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me ERRU.

Performuesi më i mirë në vitin 2014 përse i përket treguesit "Perceptimi rregullator" është Sha UK Lezhë e cila ka marrë pikët maksimale (100 pikë) e cila bën pjesë në grupin e dytë, e ndjekur nga Sha U Bulqizë e grupit të dytë me 95 pikë, ndërsa në grupin e parë dallohen Sh.a UK Korçë dhe Elber Sh.p.k (sot Elbasan Qytet Sha) me 90 pikë.

3.2 Renditja e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime

Në këtë kapitull pasqyrohet vlerësimi i performancës së përgjithshme të shoqërive UK, bazuar në totalin e pikëve të grumbulluara nga vlerësimi i çdo treguesi kryesor të performancës. Bazuar në këtë vlerësim shoqëritë ujësjiellës kanalizime janë renditur sipas performancës së tyre përgjithshme.

ERRU është përpjekur që vlerësimi i performancës të jetë sa më real. Duke qenë se analiza e performancës është bazuar në të dhënat e raportuara nga shoqëritë, cilësia e të dhënave të raportuara luan një rol të rëndësishëm në rezultatet e vlerësimit. Problemet e konstatuara si në raportimin e të dhënave, pasaktësitë apo mospërputhjet në raportim shtrojnë para rregullatorit domosdoshmërinë për të intensifikuar punën në lidhje me sasinë, cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave. Për periudhën në vazhdim, në programet e punës së ERRU një vend të rëndësishëm do të zënë programet e kontrollit të të dhënave të raportuara, në veçanti të dhënat që lidhen me TKP, zbatimin e kuadrit ligjor dhe shërbimin ndaj konsumatorit.

Renditja e shoqërive sipas performancës së përgjithshme

Shoqëritë janë renditur sipas pikëve totale të performancës të llogaritura mbi bazën e vlerësimit të 8 nga 10 TKP. Secili prej treguesve kryesorë të performancës ka një peshë specifike të caktuar që tregon rëndësinë relative të tij. Maksimumi i pikëve që mund të arrihen është 100 pikë. Çdo TKP vlerësohet me një rezultat maksimal nga 5 deri në 20 pikë, në varësi të peshës specifike që i është caktuar dhe ka kufijtë e tij maksimalë dhe minimalë të performancës.

Performancë e mirë konsiderohen arritjet e shoqërisë në nivelin e objektivave të vendosur nga ERRU. Përgjithësisht, nëse performanca është nën këtë objektiv, me qëllim inkurajimin dhe vlerësimin hap pas hapi të përmirësimeve vlerësimi bëhet vetëm për një përqindje të pikëve në dispozicion. Për disa tregues si eficientia e stafit, uji pa të ardhura dhe norma e arkëtimit performanca baraz apo nën nivelin minimal të pranueshëm të objektivave të vendosur nga ERRU vlerësohet me zero pikë.

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat e performancës		Pesha specifike	Pikët maksimale
		Pikë të plota	0 Pikë	Totali 100%	
1 - Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	0%	15%	15
2 - Mbulimi i Kostos Totale		Nuk është përfshirë në vendosjen e pikëve			
3 - Norma e Arkëtimit		≥ 82%	≤ 60%	20%	20
4- Efienca e Stafit (Staf për 1000 lidhje)	Grupi 1	≤ 4	≥ 6	5%	5
	Grupi 2	≤ 6	≥ 10		
	Grupi 3	≤ 10	≥ 15		
5 - Uji pa të Ardhura		≤ 30%	≥ 50%	20%	20
6 - Niveli i Matjes		≥ 85%	0%	15%	15
7 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 ore/ditë	0%	15%	15
8. Cilësia e ujit		Nuk është përfshirë në vendosjen e pikëve			
9- Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	0%	5%	5
10- Perceptimi Rregullator		100 pikë	0 pikë	5%	5

Tabela 8. Sistemi i renditjes së shoqërive: TKP, Objektivat , Pesha specifike për çdo TPK, pikët

Rezultatet e renditjes për vitin 2014

Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes	Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	UK	Korçë	99.50	30	U	Divjakë	55.64
2	UK	Librazhd	97.64	31	U	Tepelenë	55.39
3	U	Bilisht	94.00	32	U	Gjirokastër Fshat	54.32
4	UK	Rubik	82.90	33	UK	Ura Vajgurore	53.62
5	UK	Pogradec	78.28	34	UK	Himarë	49.43
6	UK	Ersekë	77.84	35	UK	Mallakastër	47.97
7	U	Gramsh	77.81	36	UK	Fushë Krujë	47.88
8	U	Delvinë	75.87	37	UK	Gjirokastër	47.54
9	UK	Tirane	71.51	39	U	Polican	46.32
10	UK	Elber sh.pk	70.60	40	UK	Vlorë	45.90
11	U	Elbasan Fshat	70.04	38	U	Peshkopi	44.41
12	UK	Lezhë	69.13	41	UK	Fushë Arrëz	43.47
13	U	Përmet	68.38	42	UK	Selenicë	43.24
14	U	Lushnjë Fshat	68.08	43	UK	Libohovë	43.18
15	UK	Bashkia Pukë	67.76	44	UK	Mirditë	41.57
16	UK	Burrel	67.37	45	U	Shkodër Fshat	39.90
17	U	Korçë Fshat	67.07	46	U	Këlcyre	38.17
18	UK	Peqin	66.05	47	U	Bulqizë	37.32
19	UK	Lushnjë	65.66	48	U	Has	34.18
20	UK	Kukës	65.59	49	UK	Pukë Fshat	30.28
21	UK	Durrës	61.80	50	U	Patos	29.11
22	UK	Fier	60.82	51	U	Kurbin	28.26
23	UK	Berat - Kuçovë	60.77	52	U	Novoselë	27.22
24	UK	Rrogozhinë	60.01	53	U	Vau i Dejës	25.73
25	UK	Krujë	59.00	54	U	Tropojë	25.68
26	UK	Krastë	58.15	55	U	Orikum	22.35
27	UK	Kavajë	57.14	56	U	Çorovodë	21.68
28	UK	Sarandë	56.42	57	UK	Bradashesh	-
29	U	Shkodër	56.10				

Tabela 9. Tabela e renditjes së shoqërive për vitin 2014

Në tabelën e mësipërme 57 shoqëritë e marra në analizë janë renditur sipas pikëve të rezultatit të përgjithshëm të performancës. Siç edhe është sqaruar më parë, në këtë vlerësim nuk bën pjesë Sha UK Bradashesh e cila nuk ka raportuar të dhëna gjatë vitit 2014.

Performuesit më të mirë

Performuesit më të mirë në secilin grup paraqiten në tabelën 9. Pavarësisht nga rezultati, pjesë e vlerësimit janë vetëm shoqëritë të cilat operojnë në përputhje me kuadrin rregullator, pra kanë një licensë të vlefshme dhe tarifa të miratuara nga ERRU. Për vitin 2014, shoqëritë më rezultatet më të mira janë:

Renditja	Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3	
	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	Korçë	99.50	Librazhd	97.64	Rubik	83.90

Tabela 10. Performuesit më të mirë në Renditjen e Shoqërive për Vitin 2014

Në grupin e parë, SHA UK Korçë është shoqëria me performancën më të mirë. Për të katërtin vit, kjo shoqëri renditet e para edhe në listën e renditjes së shoqërive sipas performancës së përgjithshme. Diferenca nga maksimumi i pikëve është vetëm 0.5 pikë.

Në grupin 2 e para renditet SHA UK Librazhd. Kjo shoqëri renditet e dyta në vlerësimin e përgjithshëm të shoqërive me një difference prej 2.36 pikë nga maksimumi i pikëve.

Në grupin 3, renditet e para Sh. a U Rubik. Sipas pikëve të vlerësimit të performancës së përgjithshme kjo shoqëri renditet e katërta. Diferenca nga maksimumi i pikëve është vetëm 17.90 pikë.

Shoqëritë me ecurinë më të mirë në kohë

Renditja e shoqërive në bazë të pikëve të grumbulluara pasqyron arrijet aktuale të tyre dhe shërben për identifikimin e shoqërive me nivelin më të mirë të performancës sipas grupeve përkatëse. Por ka edhe shoqëri, edhe pse jo të renditura në vendet e para, që bëjnë përpjekje domethënëse për të përmirësuar shërbimet dhe menaxhimin e tyre. Krahasuar me një vit më parë ecuria e mirë e punës së tyre ka sjellë më shumë pikë të grumbulluara për vitin 2014. Për të vlerësuar këto ndryshime të performancës pikët e vlerësimi i performancës së përgjithshme në vitin 2014 janë krahasuar me ato të vitit 2013. Për çdo grup shoqëria që ka patur progresin më të mirë është vlerësuar për ecurinë më të mirë. Tabela e mëposhtme paraqet “shoqëritë me ecurinë më të mirë” në secilin nga tre grupet.

Shoqëria		Renditja ne grup	Pikët e renditjes 2013	Pikët e renditjes 2014	Ndryshimi ne pikët e renditjes
Grupi 1	Durres	14	48.14	61.80	+ 13.66
Grupi 2	Bilisht	2	67.08	94.00	+ 26.92
Grupi 3	Erseke	2	73.60	77.84	+ 4.24

Tabela 11. Shoqëritë me ecurinë më të mirë në renditje për vitin 2014

Këto shoqëri ndonëse nuk janë renditur në vendet e para të vlerësimit të përgjithshëm të performancës, kanë bërë progresin më të mirë krahasuar me një vit më parë.

Në grupin e parë SHA UK Durrës megjithëse renditet në vendin e 21-të në vlerësimin e përgjithshëm të performancës, dallohet për ecurinë më të mirë me 13.66 pikë më shumë se sa në vitin 2013. Gjatë vitit 2014 kjo shoqëri ka përmirësuar ndjeshëm shkallën e mbulimit të kostove të operimit, normën e arkëtimit si dhe nivelin e matjes.

Në grupin e dytë, SHA UK Bilisht ka ecurinë më të mirë me 26.92 pikë më shumë sesa një vit më parë. Në vlerësimin e përgjithshëm të performancës renditet në vendin e 3-të. Shoqëria në vitin 2014 ka përmirësuar të gjithë treguesit kryesorë të punës krahasuar me vitin 2013 si rezultat i investimit të kryer në sistemin e furnizimit me ujë. Gjithashtu, edhe si rezultat i një menaxhimi më të mirë kjo shoqëri ka arritur të arkëtojë edhe detyrimet e prapambetura.

Në grupin e tretë ecurinë më të mirë e ka shënuar ShA UK Ersekë me 4.24 pikë më shumë krahasuar me vitin 2013. Përmirësimet kanë konsistuar kryesisht në mbulimin e kostove, normën e arkëtimit uljen e humbjeve e rritjen e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë.

Teme e Veçante: Mbrojtja e Konsumatorit



Teme e Veçante për vitin 2014: Mbrojtja e Konsumatorit

Ashtu si edhe çdo shërbim tjetër, shërbimet ujësjellës-kanalizime ekzistojnë për përdoruesit e tyre. Por, ndryshe nga shumë shërbime të tjera, konsumatorët e shërbimeve ujësjellës-kanalizime nuk mund të ndryshojnë operatorët në rast se ofrimi i këtyre shërbimeve nuk i plotëson pritshmëritë e tyre, ose në rast se një operator dështon në përmbushjen e përgjegjësisë së tij. Në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, përgjigjja ndaj nevojave dhe vëmendja tek konsumatori janë fokusuar ngadalë, pjesërisht për shkak të monopolit natyror jo konkurrues që ofrohet nga operatorët.

Mbrojtja e interesit të konsumatorëve për sa i përket cilësisë, efikasitetit dhe besueshmërisë në shërbime përkundrejt një çmimi të drejtë, është një ndër detyrat kryesore të ERRU-së siç parashikohet në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar.

ERRU vit pas viti, ka ndërmarrë iniciativa të vazhdueshme që nëpërmjet ushtrimit të mandatit të tij, të nxisë ndryshimin e sjelljes ndaj konsumatorëve të ujit, duke mos i konsideruar ata thjeshtë si marrës të shërbimit, por si klientët e vyer të shoqërive ujësjellës-kanalizime. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2014, ERRU është fokusuar në përmirësimin e instrumenteve të mëposhtëm.

Kontrata model

Në fillim të vitit 2014, kontrata model e miratuar nga ERRU në vitin 2011 ishte nënshkruar me rreth 34 % të të gjithë klientëve në sektorin UK. Me qëllimin për të siguruar të drejtën e të gjithë konsumatorëve për një shërbim cilësor, ERRU vendosi që prej muajit shtator 2014, kontrata model të rregullojë detyrimisht të gjitha marrëdhëniet mes konsumatorëve dhe shoqërive UK në Shqipëri, pavarësisht nënshkrimit të saj ose jo nga palët.

Në fund të vitit 2014, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve mori në shqyrtim kontratën model për shërbime ujësjellës kanalizime. Me anë të vendimit nr. 35, datë 18.02.2015, komisioni miratoi raportin e vlerësimit të "Kontratës për Shërbimet Ujësjellës Kanalizime për konsumatorët" dhe ngarkoi Entin Rregullator të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Nga ana tjetër ERRU 4 vjet pas miratimit të kontratës model ka gjykuar se disa momente të kontratës kishin nevojë për rishikim. Kjo jo vetëm në kuadër të përshtatjes me legjislacionin në fuqi dhe por edhe të përshtatjes me zhvillimet në sektor dhe përmirësimit të gjuhës së përdorur aty ku ishte e nevojshme.

Gjithashtu në shtator të vitit 2014 Enti Rregullator i Ujit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nënshkruan një akt-marrëveshje bashkëpunimi mbi zbatimin e legjislacionit për metrologjinë në sektorin e furnizimit me ujë dhe verifikimin e matësve të ujit në veçanti.

Ndryshimet në kontratën model u miratuan me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 25, datë 08.07.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime", i cili gjendet i publikuar në Fletoren Zyrtare dhe faqen e internetit të ERRU.

Shtesat dhe ndryshimet konsistojnë kryesisht në qartësimin e procedurave që palët duhet të respektojnë në momente të ndryshme të marrëdhënies së tyre. Këtu veçojmë procedurat për kryerjen e verifikimit të matësit, njoftimin në rast të aplikimit për ndryshimin e tarifave, kur dhe si aplikohet kamatëvonesa, e drejta për t'u ankuar dhe momente të tjera.

Seanca dëgjimore me publikun

Në metodologjinë për vendosjen e tarifave, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator në vitin 2011, u përfshi një koncept i ri në procesin e aplikimit për ndryshimin e tarifave, seanca dëgjimore me publikun. ERRU duke dashur ta përfshijë konsumatorin në proces, jo thjesht ta informojë atë, vendosi hartimin e një udhëzuesi mbi të gjitha procedurat që shoqëria duhet të zbatojë në organizimin e një seancë dëgjimore. Seanca duhet të jetë e hapur dhe për pjesëmarrjen në të, duhet të merren masa për njoftimin e të gjithë konsumatorëve që marrin shërbim nga shoqëria.

Komisioni miratoi, në gusht të vitit 2015, udhëzuesin për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave të furnizimit me ujë dhe/ose largimit, dhe/ose përpunimit të ujërave të ndotura. Ky udhëzues përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga operatorët e mëdhenj për organizimin e seancës dëgjimore me publikun, si pjesë e procesit të dokumentacionit për aplikim për ndryshim të tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime. Shoqëria duhet të zhvillojë seancën dëgjimore me publikun me qëllim informimin dhe diskutimin me konsumatorët lidhur me ndryshimin e tarifave, arsyet e këtyre ndryshimeve, investimet, planet për të ardhmen si dhe marrjen e komenteve nga palët e interesuara lidhur me këto propozime. Në këtë mënyrë synohet të rritet transparencja dhe llogaridhënia ndaj publikut.

Procesi i ankesave te konsumatoreve

Mbrojtja e konsumatorit lidhet dhe me çështjen e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave. Ky proces mbetet një nga problemet më të ndjeshme në marrëdhënien mes ERRU-së dhe konsumatorëve, i cili ka jo pak vështirësi në trajtim.

Aktualisht, çdo person i interesuar mund të paraqesë një ankesë me shkrim në ERRU nëse ai/ajo është i mendimit që operatori nuk përmbush detyrimet ligjore ose/dhe kontraktuale. Si instancë e parë, çdo ankesë duhet të paraqitet tek operatori dhe në rast se klienti mbetet i pakënaqur apo problemi i trajtuar në ankesë vazhdon, ankesa me shkrim mund të paraqitet dhe pranë ERRU-së. ERRU analizon çështjen e trajtuar, duke informuar operatorin e licencuar mbi shkeljen e pretenduar të kontratës apo kundravajtjes me ligjin, si dhe duke kërkuar nga ata një deklaratë me shkrim mbi këtë ankesë.

ERRU në trajtimin e ankesave ka vetëm rolin e një ndërmjetësi midis konsumatorit dhe operatorit dhe gjithsesi nuk ka mundësi të marrë një vendim mbi të drejtën ose jo të konsumatorit.

Në këtë situatë pjesë e zgjidhjes së këtij problemi, do të ishin ndryshimet që priten ti bëhen ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ku pjesë e të cilave është dhe shtimi i kompetencës së KKRR për marrjen e vendimit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Pavaresisht nga sa me lart, ERRU në ushtrim të mandatit të saj në mbrojtje të konsumatorit, po punon për të përgatitur një standard të miratuar të trajtimit të ankesave nga operatorët, i cili pritet të finalizohet së shpejti. Ky dokument ka si objekt përcaktimin e kushteve të përgjithshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, në mënyrë që të sigurohet një proces i drejtë dhe efektiv ankimi, si dhe të rritet besimi i konsumatoreve për këtë shërbim të ofruar nga operatorët.

Këto standarde janë hartuar në mbështetje të:

- Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve";
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 "Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime / Kodi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime;
- Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Në vijim të miratimit të standardit të mësipërm, u pa e arsyeshme që roli i marrëdhënies së operatorit me konsumatorin të përfshihej dhe në vlerësimin e performancës së shoqërive. Pjesë e projektit të ERRU për "Sistemin e raportimit rregullator" është edhe shtimi i treguesit të performancës që do të masë korrektësinë e operatorëve në trajtimin e ankesave të konsumatorëve, bazuar në standarde të mirëpërcaktuara.

Konkluzione dhe Prespektiva për të ardhmen

Enti Rregullator i Ujit është përpjekur që shërbimi ndaj konsumatorëve të jetë gjithnjë e më cilësor, i ofruar nga operatorë të licencuar, me tarifa të miratuara prej tij, duke patur gjithnjë në vëmendje konsumatorin. Në këtë kuadër, ERRU do të vazhdojë nxisë dhe mbështesë shoqëritë UK që bëjnë përpjekje për të përmirësuar efikasitetin e tyre operacionale. Gjithashtu, përmirësimi i instrumenteve rregullatore do të ndihmojë shoqëritë për të përmirësuar menaxhimin e brendshëm të tyre me qëllim uljen e kostove të shërbimit dhe rritjen e të ardhurave.

Konkluzione nga analiza e performances për shoqëritë UK

Burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK është arkëtimi i të ardhurave që realizohen nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura për konsumatorët në zonën e tyre të juridiksionit. Për vitin 2014, niveli i arkëtimit ka pësuar një rritje të konsiderueshme prej rreth 6% në krahasim me vitin 2013.

Megjithatë, shoqëritë UK duhet ti japin përparësi faturimit dhe arkëtimit në kohë, në mënyrë që qëndrueshmëria financiare të përmirësohet. Për shumë shoqëri arkëtimi i borxheve të këqija vazhdon të jetë problematik. Një ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi ka ofrimi i shërbimeve cilësore. Eksperiencat tregojnë se shoqëritë që ofrojnë shërbime cilësore kanë normë arkëtimi të lartë, konsumatorët nuk hezitojnë të paguajnë edhe nëse tarifat rriten.

Lehtësimi i procesit të arkëtimit ndihmohet nga rritja e nivelit të matjes së shërbimeve, sidomos për klientët familjare. Pavarësisht rritjes që ka shënuar ky tregues gjatë viteve të fundit, rezultat që për vitin 2014 ka arritur në 91%, akoma faturimi aforfe është në nivel të lartë, ndërkohë që ky proces duhet të ishte mbyllur me kohe. Në sektor, vetëm një numër i kufizuar operatorësh kanë instaluar matësit për të gjithë klientët, pjesa më e madhe ofron shërbim të matur dhe të pamatur, por ka edhe shoqëri të cilat pothuajse nuk ofrojnë fare shërbim të matur për konsumatorët.

Përveç kësaj, pjesa më e madhe e shoqërive akoma nuk ka të vendosur matësit e bilancit dhe matësit zonale, të dhënat për volumin e ujit të prodhuar dhe shpërndarë për konsumatorin akoma janë të vlerësuara për më tepër se gjysmën e shoqërive. Vendosja e këtyre matësive i ndihmon operatorët të operojnë me të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e prodhuar, faturuar dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga ky faturim.

Gjithashtu shërbimi i matur çon dhe në reduktimin e nivelit të humbjeve. Uji pa të ardhura, është një tregues i cili të paktën në tre vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira dhe përben shqetësimin kryesor në sektor. Niveli i humbjeve në sektor akoma është 67.2% e ujit të prodhuar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë nuk gjeneron të ardhura.

Për të disatin vit radhazi shoqëritë ujësjellës & kanalizime (parë si mesatare e tregut) arrijnë të mbulojnë tërësisht kostot operative, duke arritur në një nivel mesatar mbulimi prej 122%. Kjo tregon për një përmirësim të gjendjes financiare të shoqërive. Gjithsesi, vetëm 7 shoqëri nga 58 mbulojnë tërësisht kostot, ndërkohë që mbulimi mesatar i kostove totale të të gjitha shoqërive është rreth 87%, gjë që tregon se shoqëritë ende varen nga subvencioni i qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Janë pak ato shoqëri situata financiare e së cilave është mëse e qëndrueshme (mbulojnë tërësisht kostot), ndërkohë që shumica e shoqërive të vogla dhe të mesme ende nuk mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve totale për aktivitetin e tyre.

Përmirësimi i situatës financiare të shoqërive vjen prej njohjes së kostove, masave për ti ulur ato, mbledhjes së të ardhurave dhe investimeve të mirëmbledhura. Si një mënyrë për të ndikuar direkt mbi rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive, ERRU e ka bazuar miratimin e aplikimeve për tarifa në analizën e gjendjes aktuale të shoqërisë, arritjen e objektivave të vendosur nga rregullatori dhe mbi nevojën për zbatimin e planeve të biznesit të shoqërive përkatëse. Në këtë mënyrë tarifa, nuk është parë thjesht si një mjet me anë të së cilit shoqëria ka nevojë të mbulojë kostot e saj, por si një instrument politikash për krijimin e një tregu të qëndrueshëm.

Rregullatori do të vazhdojë ta konsiderojë instrumentin e tarifës si një mjet të rëndësishëm për përmirësimin e treguesve të efikasitetit duke u munduar të influencojë edhe akordimin e investimeve nga qeverisja qendrore nëpërmjet formulave që krijojnë incentive për shoqëritë UK “performuesit më të mirë shpërblehen”.

Perspektiva për të ardhmen

ERRU do të vazhdojë të monitorojë performancën e sektorit në tërësi si dhe aspekte të veçanta të këtij shërbimi, rezultatet e të cilave do të bëhen publike dhe do të jenë objekt diskutimi me palët e interesit më qëllim përmirësimin e qëndrueshëm të shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve.

Këtë vit ERRU e ka kryer analizën e performancës bazuar në treguesit kryesorë të saj, por duke u thelluar me tej dhe në analizën e nën-tregueseve në mënyrë që vlerësimi për çdo operator të jetë më i gjerë dhe më i detajuar për të evidentuar shkaqet dhe problemet që

lidhen me nivelin dhe ecurinë e tyre. Kjo punë e nisur do të vazhdoje dhe më tej në vitet në vijim.

Në veçanti do të vazhdohet të punohet për të rritur saktësinë e të dhënave. Inspektimet, kontrolli dhe verifikimi i të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimit do të vazhdoje të jetë një nga prioritetet e punës së rregullatorit.

Për të identifikuar pikat e nisjes për një efikasitet më të mirë të shoqërive UK është e nevojshme të zhvillohen analiza më të detajuara në veçanti për treguesit si: uji pa të ardhura, niveli i matjes, menaxhimi i kostove, efikasiteti dhe energjia e norma e arkëtimit, kryesisht duke u fokusuar në:

- Vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer - Megjithatë rritjen e performancës financiare të shoqërive UK të mesme dhe të mëdha, shoqëritë duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshme në kryerjen e analizës për kostot e shërbimeve që kryejnë. Për ERRU ndarja e shpenzimeve sipas qendrave të kostos merr një rëndësi të veçantë në përcaktimin e kostove të domosdoshme e të arsyeshme për kryerjen e çdo shërbimi.
- Efikasitetin e energjisë - Ulja e shpenzimeve për energjinë duhet të jetë një nga drejtimet kryesore të punës së shoqërive, pasi aktualisht këto shpenzime kanë peshë të konsiderueshme në totalin e kostove.
- Menaxhimin e aseteve - Identifikimi dhe hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve mundëson jo vetëm një menaxhim më të mirë të aktiveve fikse por edhe uljen e kostove.
- Bilancin e ujit si një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura - ERRU do të vazhdojë punën e nisur që nga viti 2013 për plotësimin dhe analizën e tij nga çdo shoqëri. Analiza e bilancit të ujit është një domosdoshmëri për operatorët. Ato duhet të marrin masa urgjente duke filluar me vendosjen e matësve në prodhim dhe ato të bilancit, fillimisht për të njohur situatën reale të humbjeve. Gjithashtu dhe me evidentimin dhe eliminimin apo legalizimin e lidhjeve të paligjshme, qoftë në transmetim ashtu edhe në shpërndarje
- Planet e Biznesit si instrumenti më i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të shoqërive UK - ERRU mbështet të gjitha ato shoqëri që kanë hartuar planet e tyre të biznesit si dhe ato që janë duke punuar për këtë qëllim. Gjithashtu, Rregullatori do të nxisë të gjitha shoqëritë e tjera të punojnë për të patur planet e tyre të biznesit duke synuar që investimet të drejtohen kryesisht në zonat e pambuluara me shërbime ujësjellës kanalizime.

ERRU edhe në të ardhmen do të punojnë për të rritur dhe forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin dhe bashkëpunimin ndër institucional për të krijuar ekuilibrin e duhur ndërmjet ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorëve.

6

Anekse: Të dhënat kryesore të përzgjedhura



Nr	Aktiviteti	Emertimi	Për Ujin e pijshëm lek/m3			Tarife shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			Familjare	Buxhetor	Privat	Familjare	Buxhetor	Privat	Familjare	Buxhetor	Privat
Grupi 1	UK	Tirane	45	120	135	100	100	100	11	30	35
	UK	Durres	58	110	120	100	100	100	35	50	50
	UK	Vlore	30	60	80	80	80	80	11	13	13
	UK	Elber sh.p k	38	115	130				8	25	30
	UK	Fier	52	105	125	200	200	200	13	18	20
	UK	Shkoder	40	110	110	100	100	100	15	20	20
	UK	Berat - Kucove	44	125	125	100	200	200	12	20	20
	UK	Kavaje	38	80	100	100	100	100	15	20	20
	UK	Korce	65	110	140	120	120	120	34	56	56
	U	Elbasan fshat	36	110	110	100	100	100			
Grupi 2	UK	Sarande	44	120	120	100	100	100	16	25	25
	UK	Pogradec	22/62	37/111	37/111	200+100	400+100	400+150	11./33	12./36	12./36
	UK	Lushnje	54	125	135	100	200	200	15	20	22
	UK	Gjirokaster	39	112	124	80	80	80	9	14	14
	UK	Lezhe	58	135	145	200	200	200	18	22	27
	U	Korce fshat									
	U	Lushnje fshat	60	70	100						
	U	Kurbin	30	80	120	50	50	50			
	UK	Librazhd	38	100	100				13	22	23
	UK	Kukes	25	60	80				7	15	20
	U	Shkoder fshat	50	120	120						
	UK	Patos									
	UK	Burrel	23	60	80				2	4	6
	UK	Rrogozhine	48	90	100	50	100	100	10	12	12
	U	Mallakaster									
	UK	Gramsh	32	90	90						
	UK	Kruje	33	80	80				8	12	12
	UK	Tepelene	33	100	120	90	400	250	12	20	20
	U	Peshkopi	27	65	85				10	15	18
Grupi 3	U	Permet	40	110	120	100	100	200			
	UK	Himare									
	U	Bilisht	38	100	110	50	50	50			
	U	Divjake									
	UK	Delvine	48	100	100						
	U	Ura Vajgurore	40	90	100						
	UK	Peqin	30	90	100	50	50	50			
	U	Bulqize	17	55	75	100	100	100			
	U	Novosele	33	50	70						
	UK	Fushe Kruje	28	60	80				6	10	12
	U	Orikum	25	70	75	100	100	100			
	UK	Erseke	32	60	80				6	6	8
	U	Polican	37	80	95						
	U	Tropoje	19	60	80						
	U	Selenice	30	80	100						
	U	Corovode	27	80	95						
	U	Has									
	UK	Mirdite	30	100	115				10	15	15
	UK	Bashkia Puke	35	130	140	100	100	100	8	16	16
	U	Kelcyre									
	U	Vau i Dejes									
	UK	Libohove									
	UK	Rubik	30	70	100				7	10	15
	UK	Fushe Arrez									
	UK	Puke fshat									
	UK	Kraste	30	80	100				7	10	15
	U	Gjirokaster fshat	25	60	60						
	U	Bradashesh									

Tabela 12. Tarifat e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve

Nr.	Emri i shoqerise / nj. admn.	Nr. total i lidhjeve te ujit (me dhe pa mates) - Total	Nr total I lidhjeve kanalizime	Numri total i te punesuarve qe merren me aktivitetet e ndermarrjes	Vellimi total i ujit te prodhuar nga dy llojet e sistemeve (000 m3)	Vellimi total i ujit te faturuar tek klientet (me dhe pa mates)- Total (000m3)	Shuma e Faturuar e Ujit- Total (000 Lek)	Shuma e Faturuar e Kanalizimeve- Total (000 Lek)
Grupi 1	Tirane	186.274	163.088	1.283	103.448	32.715	2.029.990	390.115
	Durres	72.480	41.595	643	27.195	7.451	569.462	146.437
	Vlore	42.839	-	221	29.529	5.277	292.826	-
	Elber sh.p k	30.827	30.827	193	13.787	2.668	251.919	56.790
	Fier	28.954	22.283	339	10.574	4.478	333.888	45.462
	Shkoder	27.443	24.849	230	11.407	3.571	205.829	51.610
	Berat - Kucove	24.903	20.806	252	11.427	2.909	179.019	30.445
	Kavaje	23.252	6.077	210	2.962	1.569	91.541	6.094
	Korce	20.884	19.874	99	3.258	2.438	215.296	89.733
	Elbasan fshat	19.967	-	207	3.308	2.112	98.998	-
Grupi 2	Sarande	16.218	11.914	93	4.166	1.130	90.569	16.946
	Pogradec	14.268	10.590	82	2.703	1.248	75.798	24.892
	Lushnje	10.782	7.304	106	4.826	1.136	77.597	11.470
	Gjirokaster	9.342	2.386	93	5.389	1.461	70.785	8.610
	Lezhe	7.878	7.877	83	2.202	1.135	101.052	21.152
	Korce fshat	6.506	-	52	999	693	14.620	-
	Lushnje fshat	6.160	-	59	587	378	27.389	-
	Kurbin	6.009	-	133	4.328	1.258	55.358	-
	Librazhd	4.986	4.610	64	684	526	25.471	7.282
	Kukes	4.976	3.434	70	985	787	25.448	3.742
	Shkoder fshat	4.710	-	91	1.546	963	47.866	-
	Patos	4.643	-	112	2.548	1.303	37.703	-
	Burrel	4.255	3.518	41	1.393	667	31.363	1.271
	Rrogozhine	4.126	1.628	31	559	297	9.328	560
	Mallakaster	4.074	1.540	95	60	414	29.533	1.914
	Gramsh	4.015	-	44	1.020	675	26.930	-
	Kruje	3.610	3.078	45	1.132	417	17.938	3.035
	Tepelene	3.550	3.550	66	1.032	430	23.634	4.825
	Peshkopi	3.501	266	36	1.841	729	26.513	1.436
	Permet	3.366	-	38	513	315	20.259	-
	Himare	3.265	989	33	836	745	31.719	9.875
Grupi 3	Bilisht	3.165	-	26	481	365	18.075	-
	Divjake	2.784	-	36	350	187	9.927	-
	Delvine	2.651	996	31	346	237	18.222	1.911
	Ura Vajgurore	2.605	-	33	851	382	18.969	-
	Peqin	2.537	-	51	651	405	28.470	-
	Bulqize	2.517	-	33	1.309	682	21.545	-
	Novosele	2.297	-	35	900	468	17.276	-
	Fushe Kruje	2.154	1.769	34	433	250	12.188	1.622
	Orikum	1.910	-	18	396	205	7.867	-
	Erseke	1.650	1.650	19	467	187	11.399	1.610
	Polican	1.574	-	39	658	206	10.839	-
	Tropoje	1.549	-	29	2.148	381	15.858	-
	Selenice	1.508	-	11	655	130	5.021	-
	Corovode	1.484	-	35	540	245	8.922	-
	Has	1.244	-	31	600	273	8.522	-
	Mirdite	1.219	1.107	28	959	241	12.786	2.579
	Bashkia Puke	1.121	1.117	21	375	152	9.146	769
	Kelcyre	1.002	-	14	636	100	5.253	-
	Vau i Dejes	912	-	8	585	184	5.314	-
	Libohove	783	80	7	226	157	4.195	-
	Rubik	575	545	11	134	106	3.551	756
	Fushe Arrez	572	548	9	507	114	3.344	1.070
	Puke fshat	523	78	19	420	127	2.281	230
	Kraste	421	353	13	154	111	3.020	492
	Gjirokaster fshat	196	-	11	492	378	1.698	-
	Bradashesh							

Nr.	Emri i shoqërisë / nj. admn.	Shuma e Faturuar U&K- Total (000 Lek)	Te ardhura të tjera operative (Ujesjelles) (000 Lek)	Shuma Totale e Arketuar nga aktiviteti kryesor i U&K- Total (000 Lek)	Kosto Direkte e Operimit (KDO)- Ujesjelles (000 Lek)	Kosto Direkte e Operimit (KDO)- Kanalizime (000 Lek)	KOSTO OM	Kosto Totale e Operimit- Ujesjelles (000 Lek)	Kosto Totale e Operimit- Kanalizime (000 Lek)	KOSTO TOTALE
Grupi 1	Tirane	2.420.105	270.395	2.688.451	1.397.588	38.853	1.436.441	2.025.373	67.677	2.093.050
	Durrës	715.899	43.057	487.024	719.941	115.841	835.782	819.440	202.382	1.021.822
	Vlorë	292.826	-	208.045	266.668	16.954	283.622	431.352	16.954	448.306
	Elber sh.p.k	308.709	1.184	288.247	226.917	2.767	229.684	283.881	2.791	286.672
	Fier	379.350	-	283.538	281.712	11.749	293.461	376.355	28.549	404.904
	Shkoder	257.439	1.271	174.792	182.283	25.631	207.915	214.320	29.024	243.344
	Berat - Kucove	209.464	2.868	176.953	130.207	16.059	146.266	185.991	20.885	206.876
	Kavaje	97.635	6.509	78.564	99.839	6.879	106.718	166.449	12.113	178.562
	Korçë	305.028	5.889	283.651	103.563	71.535	175.098	160.246	167.998	328.244
	Elbasan fshat	98.998	12.581	101.364	181.827	-	181.827	196.292	-	196.292
Grupi 2	Sarandë	107.515	1.423	79.155	74.787	4.316	79.103	116.977	15.866	132.843
	Pogradec	100.690	2.356	83.932	52.835	24.147	76.982	99.066	48.573	147.639
	Lushnjë	89.067	2.283	80.598	78.803	7.454	86.257	109.675	13.249	122.924
	Gjirokastër	79.394	2.709	73.961	63.420	5.484	68.904	67.320	6.144	73.464
	Lezhë	122.204	5.531	88.905	90.658	9.730	100.388	121.708	18.943	140.651
	Korçë fshat	14.620	145	13.589	34.121	-	34.121	40.331	114	40.445
	Lushnjë fshat	27.389	480	24.105	42.376	-	42.376	66.376	-	66.376
	Kurbin	55.358	150	40.807	107.245	-	107.245	115.103	-	115.103
	Librazhd	32.753	2.961	32.629	30.440	4.880	35.320	35.660	6.140	41.800
	Kukës	29.190	268	20.960	32.520	5.947	38.468	45.788	7.314	53.102
Grupi 3	Shkoder fshat	47.866	30	27.286	65.865	-	65.865	114.972	-	114.972
	Patos	37.703	161	33.388	164.679	-	164.679	172.779	-	172.779
	Burrel	32.634	-	26.977	14.460	1.073	15.533	17.364	1.193	18.557
	Rrogozhinë	9.888	-	9.317	16.252	3.031	19.283	21.744	4.077	25.821
	Mallakastër	31.447	871	26.922	65.675	1.682	67.357	76.210	1.682	77.892
	Gramsh	26.930	-	23.833	23.968	-	23.968	30.658	-	30.658
	Krujë	20.973	587	15.527	19.840	840	20.680	39.306	6.660	45.966
	Tepelenë	28.459	12	25.951	51.580	3.435	55.015	64.183	3.435	67.618
	Peshkopi	27.949	60	19.824	20.839	303	21.141	28.152	303	28.455
	Permet	20.259	410	19.365	23.963	-	23.963	28.394	-	28.394
Grupi 3	Himare	41.594	-	13.865	21.348	1.153	22.501	24.458	1.325	25.783
	Bilisht	18.075	574	18.966	17.375	-	17.375	18.654	-	18.654
	Divjake	9.927	418	8.977	15.754	-	15.754	20.029	-	20.029
	Delvinë	20.133	-	15.844	20.201	1.409	21.609	22.200	1.937	24.137
	Ura Vajgurore	18.969	340	19.835	24.933	-	24.933	29.853	63	29.916
	Peqin	28.470	-	32.328	37.367	-	37.367	42.713	-	42.713
	Bulqizë	21.545	317	14.056	21.286	-	21.286	24.487	-	24.487
	Novosele	17.276	65	9.739	31.522	-	31.522	40.426	-	40.426
	Fushë Krujë	13.810	271	8.753	17.346	2.998	20.344	27.248	3.373	30.621
	Orikum	7.867	169	4.900	19.200	-	19.200	20.103	-	20.103
Grupi 3	Ersekë	13.009	278	13.804	7.845	1.662	9.508	9.645	2.082	11.728
	Polican	10.839	15	8.409	26.530	-	26.530	30.728	-	30.728
	Tropojë	15.858	30	5.715	12.250	-	12.250	15.550	-	15.550
	Selenice	5.021	-	4.592	13.008	-	13.008	19.008	-	19.008
	Corovodë	8.922	-	6.205	22.482	-	22.482	31.752	-	31.752
	Has	8.522	-	5.655	17.975	-	17.975	22.499	-	22.499
	Mirditë	15.365	-	10.149	22.865	4.054	26.919	25.974	4.054	30.028
	Bashkia Pukë	9.915	-	12.544	9.204	2.083	11.287	10.945	3.513	14.458
	Kelcyre	5.253	22	5.115	8.965	-	8.965	9.328	-	9.328
	Vau i Dejës	5.314	-	3.285	12.098	-	12.098	12.422	-	12.422
Grupi 3	Libohovë	4.195	-	2.682	8.213	452	8.665	9.893	566	10.459
	Rubik	4.306	-	3.943	4.377	890	5.268	4.239	1.143	5.382
	Fushë Arrez	4.414	-	3.472	5.995	1.575	7.570	7.852	1.726	9.578
	Pukë fshat	2.511	-	1.852	7.320	1.683	9.003	9.840	2.763	12.603
	Kraste	3.512	-	3.518	5.602	528	6.130	8.539	863	9.401
	Gjirokastër fshat	1.698	10	1.611	6.432	-	6.432	8.338	-	8.338
	Bradashesh	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

